



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Bioteknologji”

ofruar nga

Universiteti "Western Balkans"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr Anila Hoda

Prof. Dr Mirela Lika (Çekani)

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: “Bioteknologji”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Western Balkans"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Bioteknologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 421, datë 14.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022 – 2023 15 PAE / 2 PAK; Viti akademik 2023 – 2024 13 PAE / 2 PAK; Viti akademik 2024 – 2025 19 PAE / 4 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022 – 2023 10 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 8 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 11 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Western Balkans", është licensuar me VKM nr.679, datë 10.11.2021. Universitetit "Western Balkans", i është dhënë leja për fillimin e veprimtarisë sipas Urdhër MAS nr. 452, datë 25.07.2022. Universiteti "Western Balkans", ka në përbërje tre fakultete:

1. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit;
2. Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Programi i studimit bachelor në "Bioteknologji" ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, Universiteti "Western Balkans". Programi është licensuar me Urdhër MAS Nr. 421, datë 14.07.2022, dhe zhvillohet në formën me kohë të plotë, kohëzgjatje 3 vite akademike / 6 semestra, në gjuhën angleze. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit është i përbërë nga 4 njësi bazë si më poshtë:

1. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë;
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës;
3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
4. Qendra Kërkimore- Shkencore SMTI;

Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor në Bioteknologji", i ofruar nga Universiteti "Western Balkans" (WBU), është një program i orientuar drejt zhvillimeve bashkëkohore në fushën e bioteknologjisë, duke pasur në fokus integrimin e teorisë, praktikës dhe kërkimit shkencor. Programi është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve themelore të institucionit (Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregulloret përkatëse) dhe është i përputhshëm me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Struktura kurrikulare përfshin 180 kredite të shpërndara në 6 semestra, me lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe komponentë praktikë. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze dhe përfshin përdorimin e teknologjive moderne dhe platformave digjitale. Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë në fushë, si dhe nga infrastrukturë laboratorike e përshtatshme për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.

WBU ka krijuar partneritete të qëndrueshme me institucione të arsimit të lartë, spitale dhe laboratorë ndërkombëtarë si American Hospital, Hygea dhe Cambridge Clinical Laboratories. Studentët përfitojnë nga programet e praktikës EPIC dhe kanë mundësi të përfshihen në kërkime të aplikuara. Përmes mekanizmave të vetëvlerësimit dhe pjesëmarrjes së studentëve në vlerësime periodike, institucioni synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Gjithashtu, janë parashikuar procedura për përditësimin e kurrikulës në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore. Megjithatë, mbetet për t'u adresuar një rekomandim i pazbatuar nga akti i licencimit. Në tërësi, programi përmbush standardet ligjore dhe akademike për organizimin dhe ofrimin e një cikli studimesh Bachelor në fushën e bioteknologjisë, me orientim të qartë drejt ndërkombëtarizimit, inovacionit dhe integritetit të studentëve në tregun e punës dhe studimet e mëtejshme.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 21.05.2024, Universiteti "Western Balkans", ka aplikuar pranë ASCAL për akreditimin për herë të parë të programit të studimit Bachelor në: "Bioteknologji", i cili ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti "Western Balkans", për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr Anila Hoda** dhe **Prof.Dr. Mirela Lika(Çekani)**. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Majlinda Demirneli.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti "Western Balkans", për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti "Western Balkans", po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 23 dhe 24 Prill 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universiteti "Western Balkans". Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Universiteti "Western Balkans" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.06.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/27 Prot, datë 26.06.2025. Universiteti "Western Balkans" njofton më datë 03.07.2025, nëpërmjet sistemit me anë të shkresës me Nr. 345/1 Prot, datë 02.07.2025 "*Kthim përgjigje*", ku pranohen rekomandimet e lëna nga GVJ, si një mundësi për përmirësim. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Bioteknologji

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësishë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Western Balkans” (WBU), paraqet të dhëna faktike mbi statusin ligjor, gamën e programeve që ofron, si dhe strukturën dy gjuhësore të mësimdhënies. WBU ofron 21 programe studimi, mes tyre edhe në fusha me rëndësi për zhvillimin kombëtar si Bioteknologjia, Mjekësia dhe Inovacioni, çka tregon për një orientim drejt prioritetëve bashkëkohore të arsimit dhe kërkimit. [Ev.1; 2]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni i WBU është i orientuar drejt ekselencës në arsimin e lartë, kërkimit shkencor dhe formimit të profesionistëve për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të kujdesit shëndetësor, çka përkon drejtpërdrejt me fushat që mbulon programi “Bachelor në Bioteknologji”. Theksohet se ky program është hartuar në përputhje me Statutin e universitetit dhe me rregulloren përkatëse të fakultetit, gjë që tregon për përputhje formale me dokumentacionin institucional. [Ev.1; 6]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” është hartuar në përputhje me dokumentet bazë të institucionit (Statutin, Rregulloren Themelore dhe Strategjinë e Zhvillimit 2023–2030). Përputhshmëria me fushat akademike të institucionit është evidentuar përmes përqendrimit të programit në disiplina bashkëkohore të lidhura ngushtë me profilin shkencor të universitetit. Veçanërisht theksohet roli i programit në ofrimin e një kombinimi efektiv mes teorisë, praktikës dhe kërkimit, gjë që pasqyron koherencën me misionin institucional dhe objektivat afatgjata për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion. Kjo tregon se programi nuk është një nismë e izoluar, por pjesë e një vizioni më të gjerë institucional. [Ev. 1; 1.2; 2].
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se programi studimit Bachelor në “Bioteknologji” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e bioteknologjisë.



specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë në vitin akademik 2024 – 2025 ka në përbërje të tij staf akademik me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof.Asoc	-	1
Dr/PhD	5	4
Msc	2	2
Gjithsej	8	8

Megjithatë, institucioni nuk e ka përmbushur rekomandimin e dhënë në aktin e licencimit, ndaj *GVJ rekomandon* marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e këtij rekomandimi.

Në aspektin e kapaciteteve infrastrukturore, evidentohet ekzistenca e laboratorëve të specializuar dhe të mirëpajisur për biologji molekulare, mikrobiologji, imunologji dhe fusha të tjera përkatëse, si dhe laboratorë kompjuterikë me teknologji moderne për bioinformatikë dhe analizë të të dhënave biologjike [Ev. 1.5; 1.6; Vizita në institucion]. Këto elementë dëshmojnë se institucioni është i përgatitur për të realizuar praktika mësimore dhe kërkimore që kërkon një program i tillë. Për më tepër, përmendja e pajisjeve si smart boards dhe sisteme të avancuara për mësimdhënie sugjeron një mjedis modern dhe të aksesueshëm për studentët [Ev. 1.5; 1.6; Vizita në institucion].

WBU bashkëpunon me institucione kërkimore dhe spitale ndërkombëtare, si Grupi i Spitaleve Amerikan, Cambridge Clinical Laboratories dhe International Hygea Hospital [Ev. 1.8]. Këto lidhje jo vetëm që shtojnë vlerë praktike programit, por përmbushin në mënyrë të dukshme aspektin e “burimeve” dhe “eksperiencës” në fushën e bioteknologjisë, duke u ofruar studentëve mundësi reale për zhvillim profesional dhe kërkime të aplikuara. Ky bashkëpunimi i WBU me institucione kërkimore dhe spitale ndërkombëtare, i cili u mundëson studentëve të angazhohen në kërkime të aplikuara dhe të fitojnë përvojë praktike në mjedise profesionale të fushës së bioteknologjisë, konsiderohet si praktikë e mirë.

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën

Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” është në përputhje të plotë me profilin akademik të Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, i cili është njësia përgjegjëse [Ev. 1.1]. Institucioni në RVB, si nënvizon orientimin e programit drejt kërkimit shkencor dhe nevojave të tregut, duke

akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	përfshirë fusha si bioinformatika dhe programimi [Takimi me stafin akademik]. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.			
Konkluzione	<i>Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” është në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe me dokumentet themelore të institucionit.</i> <i>Programi është i orientuar drejt fushave bashkëkohore si bioinformatika dhe programimi, në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet shkencore.</i> <i>Infrastruktura përfshin laboratorë të specializuar dhe pajisje moderne që mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, dhe GVJ e konsideron si pike të forte.</i> <i>WBU bashkëpunon me spitale dhe qendra kërkimore ndërkombëtare që ofrojnë mundësi reale praktike për studentët, çka përbën një praktikë të mirë.</i> <i>Megjithatë, institucioni nuk ka përmbushur një nga rekomandimet e dhëna në aktin e licencimit, dhe rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi	Institucioni ka krijuar struktura të qarta bashkëpunimi të brendshëm për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë programin “Bachelor” në “Bioteknologji”. Ndërveprimi ndërmjet njërive dhe personelit realizohet përmes ndarjes së detyrave dhe marrjes së

brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	përgjegjësiwe sipas rolit dhe ekspertizës përkatëse. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, në kuadër të FETI-t, ka rolin qendror në zbatimin dhe koordinimin e këtij programi, duke ndjekur rregullore të brendshme të qarta akademike dhe administrative. Gjithashtu, është vendosur një sistem i analizës së vazhdueshme të performancës, i cili kontribuon në përmirësimin cilësor të proceseve mësimore dhe kërkimore, duke garantuar që programi të jetë në përputhje me nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës. Këto aspekte tregojnë për një menaxhim efektiv dhe një qasje institucionale të qëndrueshme, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri. [Ev. 1; 1.1; 1.12; 1.13]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	WBU ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit për të realizuar objektivat e procesit mësimor dhe formues të studentëve. Misioni i institucionit është qartësisht i orientuar drejt ndërkombëtarizimit, ekselencës akademike dhe inovacionit, çka reflektohet në marrëveshjet konkrete me universitete dhe institucione kërkimore, si dhe me aktorë të biznesit dhe spitale partnere si American Hospital SH.A, International Hygea Hospital SH.A dhe Cambridge Clinical Laboratories [Ev. 1.7; 1.8; 1.9]. Këto bashkëpunime mundësojnë shkëmbime akademike, pjesëmarrje në projekte kërkimore, si dhe trajnime praktike që pasurojnë përvojën e studentëve dhe u japin atyre mundësinë të zhvillojnë aftësi profesionale të drejtpërdrejta [Takimi me studentët]. Gjithashtu, përfshirja e WBU-së në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë tre viteve të fundit dëshmon për angazhimin e tij aktiv në rrjete bashkëpunimi akademik dhe kërkimor, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	WBU ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione akademike, institute kërkimore dhe kompani që operojnë në fushën e bioteknologjisë dhe në fushat përkatëse. Këto marrëveshje shërbejnë për realizimin efektiv të praktikave profesionale, klinike, të punës apo të stazheve, duke i ofruar studentëve përvojë praktike dhe aftësi të drejtpërdrejta për tregun e punës. Praktikant mbikëqyren nga përfaqësues të institucionit pritës dhe nga personeli akademik i WBU, ndërsa vlerësohen përmes dokumentacionit të plotë dhe të strukturuar. [Ev. 1.14; 1.16] Nëpërmjet programeve si EPIC (<i>Education-Practice Integrated Curriculum</i>), WBU i pajis studentët me eksperiencë

	pune të paguar pranë partnerëve institucionalë, çka demonstroi përkushtim ndaj një modeli bashkëkohor formimi profesional [Ev. 1.17]. Bashkëpunimet me aktorë si American Hospital SH.A, International Hygea Hospital SH.A dhe Cambridge Clinical Laboratories, si dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështesin më tej objektivat e këtij kriteri. Përfshirja e drejtpërdrejtë e studentëve në trajnim, leksione të hapura dhe veprimtari kërkimore e forcon mjedisin akademik dhe garanton që arsimi i ofruar të jetë i lidhur ngushtë me praktikën reale të tregut të punës.			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë përmes RVB deklaron se harton periodikisht raporte analitike si pjesë e analizës vjetore të punës, duke u përpjekur të vlerësojë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Evidenca e sugjeruar [Ev. 1.19] nuk paraqet një analizë të strukturuar të përfitimeve që rrjedhin nga këto bashkëpunime në funksion të objektivave të programit të studimit në Bioteknologji. Mungojnë tregues të qartë të vlerësimit dhe përdorimit të këtyre të dhënave për përmirësim. Nuk tregohet nëse rezultatet e analizave ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e programit të studimit.			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit ka zhvilluar bashkëpunime me institucione dhe kompani si Spitalet Amerikane, Hygeia, Intermedica Lab, duke mundësuar praktika profesionale për studentët.</i> <i>Programi EPIC është zbatuar si pjesë e strategjisë për lidhjen e teorisë me praktikën, duke përfshirë intershipë të mbikëqyrura dhe të dokumentuara.</i> <i>Raporti vjetor përmban përshkrime të aktiviteteve praktike dhe bashkëpunimeve, por mungon një analizë e strukturuar e përfitimeve nga këto marrëveshje për programin e Bioteknologjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	WBU e ka strukturuar programin e studimit “Bachelor” në “Bioteknologji” në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke garantuar transparencë dhe standardizim të procesit akademik. Secili komponent formues dhe çdo lëndë në program është e vlerësuar në kredite ECTS, duke mundësuar mobilitetin akademik ndërkombëtar. [Ev. 2.1]. Programi është i organizuar në lëndë dhe module, me 180 kredite të shpërndara në 6 semestra (3 vite). Përfshin komponentë të qartë si: - lëndë bazë (18%); - lëndë karakterizuese (51%); - lëndë ndërdisiplinore (13%); - praktika profesionale (13%); - detyrime përmbyllëse (4%); Kjo strukturë respekton ndarjen sipas kategorive A–E të përcaktuara në rregullore dhe mbulon aspektet teorike, praktike dhe kërkimore të programit. WBU ka dokumentuar qartë elementet përbërëse të programit: objektivat, kompetencat, planet mësimore, syllabuset, format e mësimdhënies (leksione, seminare, laboratorë, praktikë), dhe elementet e diplomimit. Këto janë të dokumentuara në rregulloret dhe kurrikulën e programit, siç përcaktohet në nenet përkatëse. Veprimtaritë formuese janë të vlerësuara me instrumente të përcaktuara qartë për kontrollin e dijeve dhe përmbushin standardet akademike për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave. Zbatimi i sistemit ECTS për të gjitha aktivitetet akademike siguron mundësi të barabarta për studentët në transferimin e krediteve dhe njohjen ndërkombëtare të diplomës.

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” synon zhvillimin e shprehive të veçanta që u mundësojnë studentëve të operojnë në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh brenda dhe jashtë fushës së ngushtë të bioteknologjisë, duke përfshirë përgatitjen për rolet në kërkim, industri, diagnostikë, terapi gjenike, bioinformatikë dhe nanoteknologji. Programi siguron njohuri të përparuara dhe një të kuptuar kritik të teorive dhe koncepteve moderne të bioteknologjisë. Përmes përmbajtjes së përditësuar të lëndëve dhe përfshirjes së tematikave të tilla si sekuencimi i gjeneratës së re, modifikimi gjenetik, forensika dhe nanomjekësia, studentët pajisen me një bazë të thelluar shkencore dhe teknologjike. Programi është i orientuar drejt zhvillimit të kompetencave që u mundësojnë studentëve të trajtojnë sfida të paparashikueshme dhe komplekse në mjedise të specializuara, duke kombinuar aftësi analitike, kërkimore dhe praktike. Pjesëmarrja në projekte kërkimore, mundësitë për praktikë në laboratorë të avancuar dhe bashkëpunimi me institucione të tjera (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar) sigurojnë një përgatitje gjithëpërfshirëse, që ndihmon në formimin e specialistëve që janë të aftë të kontribuojnë në mënyrë aktive në mjedise akademike dhe profesionale. [Vizita në institucion; takimi me studentët; takimi me stafin akademik].
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” është strukturuar sipas pesë kategorive të përcaktuara (A–E), duke përfshirë të gjitha komponentët formues të domosdoshëm për përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve. Ky organizim është në përputhje të plotë me kërkesat standarde për ndarjen e moduleve dhe ngarkesës në kredite. Shpërndarja e moduleve sipas kategorive A–E: • (A) Lëndë bazë – 7 lëndë x 5 kredite = 35 ECTS (18%) • (B) Lëndë karakterizuese – 17 lëndë = 92 ECTS (51%) • (C) Lëndë ndërdisiplinore / integruese – 5 lëndë = 24 ECTS (13%) • (D) Lëndë plotësuese (praktika profesionale) – 4 lëndë = 22 ECTS (13%) • (E) Detyrime përmbyllëse (tezë diplome) – 1 lëndë = 7 ECTS (4%)

	Përmbajtja e këtij kriteri është në vijimësi me të dhënat e ofruara në kriterin 1, dhe vërtetohet nga dokumente mbështetëse si: rregulloret, planet mësimore dhe kurrikulat, ku pasqyrohet ndarja e moduleve dhe ngarkesa përkatëse në kredite. [Ev.6]. Përcaktimi i qartë i moduleve dhe i krediteve për secilën kategori i mundëson studentëve të kuptojnë qartë ngarkesën akademike dhe rrjedhën e studimeve, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e progresit të tyre akademik.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi “Bachelor” në “Bioteknologji” përfshin në mënyrë të qartë praktikën profesionale si një komponent të detyrueshëm të planit mësimor. Kjo praktikë vlerësohet me notë, njësoj si të gjitha lëndët e tjera të programit, duke reflektuar rëndësinë e saj në formimin profesional të studentëve. [Ev.2] Lënda “Temë Diplome” (Kodi: BTC320) ka një ngarkesë të plotë të përcaktuar [Ev. 1.10; 6]: • 7 kredite ECTS; • 15 orë seminare dhe 160 orë punë individuale; Ajo zhvillohet në semestrin e gjashtë dhe është e udhëhequr nga supervizorë akademikë, nën përgjegjësinë e departamentit dhe me miratim nga dekanati. Temat e diplomave dhe komisionet përkatëse të mbrojtjes propozohen nga njësia bazë (Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë) dhe miratohen nga organet përgjegjëse [Ev. 1; 2.2]. Ky mekanizëm institucional siguron cilësi dhe kontroll akademik për procesin e diplomimit.
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.	WBU nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë në Republikën e Shqipërisë.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë	WBU deklaron se gjatë hartimit të programit të studimit “Bachelor” në “Bioteknologji”, është bazuar në modele të ngjashme të ofruara në institucione të arsimit të lartë brenda

studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Shqipërisë, si dhe ka marrë referencë nga programe homologe të vendeve të zhvilluara, veçanërisht të vendeve të Bashkimit Evropian. Edhe pse përgjigjja nuk e jep shprehimisht përqindjen e përputhjes, referimi ndaj modeleve ekzistuese dhe emërtimi i njëjtë sugjeron se përmbajtja e programit është ndërtuar në përputhje me standardin minimal të kërkuar prej 70%, siç parashikohet në kriter.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi "Bachelor" në "Bioteknologji" është kodifikuar sipas klasifikimeve të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin [Ev. 1.11]. Kodi i tij është 63BA0588A, ku: • 63BA tregon llojin e programit (Bachelor me 180 kredite ECTS); • 05 i referohet fushës së shkencave natyrore matematikës dhe statistikës; • 88 është numri specifik i programit; • A tregon që programi ofrohet në gjuhën angleze; Institucioni ka zbatuar edhe kodifikimin për secilën lëndë/modul të programit. Zhvillimi i programit të mësimi në gjuhën angleze konsiderohet si një pike e forte nga ana e GVJ. Përcaktimi i qartë i kodit të programit dhe kodifikimi i lëndëve garanton transparencë institucionale, lehtëson menaxhimin akademik dhe administrativ, dhe përmbush kriterin ligjor të klasifikimit sipas fushës së studimit.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit "Bachelor" në "Bioteknologji" organizohet dhe realizohet në mënyrë të pavarur nga WBU dhe nuk është program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër vendas apo i huaj. Kjo është e lejuar dhe përputhet me kriterin, pasi bashkëpunimi nuk është i detyrueshëm, por një mundësi.
Konkluzione	<i>Programi "Bachelor" në "Bioteknologji" i WBU është i strukturuar sipas kriterëve ligjorë dhe në përputhje me sistemin ECTS, me ndarje të qartë të veprimtarive formuese dhe krediteve përkatëse.</i> <i>Objektivat dhe kompetencat janë të orientuara drejt zhvillimit të aftësive për profesione të ndryshme, duke përfshirë të kuptuarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e bioteknologjisë.</i>

	<i>Strukturimi i lëndëve sipas kategorive A–E është i plotë dhe i dokumentuar, duke reflektuar një organizim të balancuar të përmbajtjes akademike.</i> <i>Ngarkesa në kredite për praktikën profesionale dhe temën e diplomës është e përcaktuar saktësisht dhe e integruar në planin mësimor.</i> <i>Programi është kodifikuar sipas udhëzimeve të ministrisë për fushën përkatëse dhe përmban kodifikimin e brendshëm të lëndëve.</i> <i>Aktualisht nuk është program i përbashkët, por është zhvilluar në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke ruajtur standardet e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti “Western Balkans”, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të parë. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.75, datë 19.04.2024 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, deri në 18/04/2030. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 4 njësi bazë: 1. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë; 2. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës; 3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike; 4. Qendra Kërkimore- Shkencore SMTI; Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore. Në Fakultetin e Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit në vitin akademik 2024 – 2025, janë angazhuar gjithsej 47 staf akademik, nga ku 31 janë staf akademik efektiv (PAE dhe 16 staf akademikme kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit					
	PAE		PAK			
Prof.Dr	2		2			
Prof.Asoc	3		2			
Dr/PhD	17		7			
Msc	9		5			
Gjithsej	31		16			

Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	1
Prof. Asoc.	1	1	1	2	-	1
Dr./PhD.	2	3	4	2	5	4
Msc.	6	2	4	-	2	2
Totali	9	6	9	4	8	8

Secila njësi bazë, pëfshirë edhe Departamentin e Bioshkencave dhe Inxhinierisë, përmbushin kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FETI, në bashkëpunim me DBI, ka siguruar një trupë të mirëorganizuar personeli ndihmës akademik dhe administrative [Ev. 2.3]. Ky angazhim është në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë dhe mbështet funksionimin praktik të programit të studimit. Angazhimi i asistentëve lektorë, laborantëve, teknikëve, dhe personelit tjetër ndihmës është i dukshëm dhe i strukturuar për të mundësuar realizimin efektiv të praktikave eksperimentale dhe profesionale në laboratorë dhe ambiente klinike. Studentët përfitojnë nga një mjedis i mbështetur në mënyrë të plotë për zhvillimin e aftësive praktike përmes mbikëqyrjes së personelit ndihmës. WBU përmes strukturave të saj mbështetëse ofron: Njësi për kurrikulën, kërkimin shkencor dhe projektet,
---	---

	• Njësi për marrëdhëniet me jashtë dhe promovimin akademik, • Strukturë të veçantë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, karrierën dhe shërbimet ligjore, • Shërbime të bibliotekës, IT-së, burimeve njerëzore dhe arkiv-protokollit. Këto struktura administrative ofrojnë bazën institucionale të nevojshme për realizimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të proceseve mësimore dhe kërkimore në mënyrë efikase. Personeli ndihmës me karakter mësimor dhe kërkimor përfshin individë që ndihmojnë në veprimtari konkrete të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ata janë pjesë integrale e njësisë bazë dhe përforcojnë aftësitë teknike dhe shkencore të studentëve përmes mbështetjes në praktikë.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	FETI dhe DBI kanë caktuar një koordinator akademik për programin “Bachelor” në “Bioteknologji”, në përputhje me kërkesat ligjore [Ev. 2.4]. Ky koordinator është pjesë e stafit akademik me kohë të plotë dhe i përket Departamentit të Shkencave Biomjekësore, çka siguron përgatitje të duhur shkencore dhe përputhje me fushën e programit. Roli i tij është shumëdimensional. Përveç koordinatorit, departamenti cakton një këshilltar akademik për çdo grup studentësh [Ev. 2; 2.1]. Kjo praktikë: • Siguron ndjekjen individuale të studentëve; • Ofron udhëzim akademik gjatë gjithë ciklit të studimeve; • Ndhmon në formalizimin e regjistrimeve dhe monitorimin e progresit; Prania e një strukture të dyfishtë – koordinatori i programit dhe këshilltari akademik – garanton efektivitetin e monitorimit dhe orientimin e studentëve, përputhur me praktikat më të mira akademike.
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe ajo bazë kanë strukturë akademike të organizuar, staf të kualifikuar dhe ndjekin të gjitha procedurat ligjore për akreditim dhe cilësi.</i> <i>Është angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ që mbështet në mënyrë të efektshme praktikat laboratorike, mësimore dhe logjistikën.</i>

	Është emëruar një koordinator i programit dhe këshilltarë akademikë për të siguruar drejtimin dhe ndjekjen e programit sipas objektivave të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FETI dhe DBI disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit "Bachelor" në "Bioteknologji". Këto elementë janë të dokumentuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, siç përcaktohet në Rregulloren e Programit, në Kurrikulën përkatëse dhe në Rregulloren për programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, duke garantuar kështu transparencë dhe përputhshmëri me standardet ligjore dhe akademike. [Ev. 1.10; 2.1].
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	WBU ka siguruar një plan mësimor të plotë dhe të detajuar. Struktura trevjeçare me gjashtë semestra është ndërtuar sipas kërkesave të sistemit ECTS dhe garanton ndarjen e qartë të lëndëve, ngarkesës mësimore dhe raportit të orëve në auditor e jashtë tij. Vlerësimi i krediteve është bërë në përputhje me standardet europiane, ku 60 kredite në vit i korrespondojnë 1500 orëve të punës së studentit. Përcaktimi i orëve për çdo aktivitet mësimor (leksion, seminar, laborator) si dhe përshkrimi i detajuar i disiplinave tregon për një transparencë të lartë akademike dhe një planifikim të kujdesshëm të ngarkesës pedagogjike. [Ev. 1.10; 2.1; 6].
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	WBU ka siguruar transparencë të plotë dhe akses të lehtë në informacionet që lidhen me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve për programin "Bachelor" në "Bioteknologji". Kriteret janë të përshkruara qartë në dokumentet zyrtare të institucionit dhe janë në përputhje me parimet e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), çka i mundëson studentëve një orientim të saktë dhe të drejtë gjatë gjithë ciklit të studimeve. Prania e rregulloreve specifike dhe referencave të detajuara tregon një angazhim institucional për të respektuar të drejtat e studentëve dhe për të

Stolo
AK

	garantuar standarde të krahasueshme me praktikat europiane, duke përmirësuar kështu cilësinë dhe besueshmërinë e procesit arsimor. [Ev. 1.10; 2].			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	WBU ka siguruar për çdo lëndë syllabus të strukturuar. Syllabuset përfshijnë të gjitha komponentët formues – teorikë dhe praktikë – si praktikat, seminarët dhe laboratorët, si dhe specifika të detajuara mbi përmbajtjen, objektivat, metodologjitë mësimore, detyrimet e studentëve dhe mënyrat e vlerësimit. Përshkrimi i orëve brenda dhe jashtë auditorit, i shpërndarë në kredite ECTS dhe në përputhje me VKM-në përkatëse është i qartë. [Ev. 2.5].			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Çdo vit akademik në WBU kryhet rishikimi i programit në bazë të analizave institucionale, vlerësimeve të studentëve dhe punëdhënësve, duke reflektuar nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore në fushën e bioteknologjisë [Ev. 2.6]. Ky proces përfshin diskutime të rregullta në departament dhe fakultet dhe finalizohet me miratimin zyrtar të ndryshimeve nga organet drejtuese, si dhe arkivimin e dosjes së përditësuar në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. GVJ u informua që e njejta praktikë do të ndiqet edhe për programin e studimit “Bioteknologji”.			
Konkluzione	WBU ofron dokumentacion të plotë, transparencë akademike dhe përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi është i strukturuar sipas standardeve ECTS, me syllabus të detajuar, mekanizma të brendshëm cilësie dhe procedura të qarta për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrít Kombëtar dhe Evropian

të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimët të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi “Bioteknologji” ka një strukturë të qartë dhe të ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe praktike, duke mbështetur zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Mësimdhënia në anglisht dhe përmbajtja ndërkombëtare rrisin mundësitë për mobilitet dhe studime të mëtejshme. Praktikant kanë peshë prej 22 ECTS (13%), por <u>mungojnë të dhëna mbi tregun e punës.</u> [Ev. 6; 1.10].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësisë profesionale. Struktura e programit (180 ECTS në 3 vite, me ndarje të qartë semestrash dhe formash të mësimdhënies) është në përputhje me standardet ligjore dhe mbështet progresin logjik të njohurive. Diversiteti i formave mësimore (leksione, seminare, laboratorë, praktikë dhe punë individuale) kontribuon në përvetësimin e njohurive teorike dhe praktike. [Ev. 6; 1.10].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit dhe raporti teori/praktikë është e balancuar dhe në përputhje me profilin shkencor të bioteknologjisë, duke përfshirë komponentë praktikë dhe punë individuale që zënë një vend të konsiderueshëm. Përqendrimi në punën individuale dhe praktike në çdo semestër është pozitiv dhe i përafërt me praktikant ndërkombëtare në këtë fushë [Ev. 6]. <u>Megjithatë, nuk paraqiten shembuj konkretë të krahasimeve me programe ndërkombëtare.</u>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese është e balancuar dhe logjike, me një shpërndarje të qëndrueshme midis përgatitjes teorike (bazë dhe karakterizuese) dhe asaj praktike (plotësuese dhe ndërdisiplinore). Praktikant profesionale dhe puna përmbyllëse mbulojnë rreth 17% të totalit të krediteve, çka ndihmon në përgatitjen për tregun e punës dhe mobilitetin.

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Procesi i përditësimit të syllabuseve është i strukturuar dhe përfshin instrumente të cilësisë si: pyetësorë të studentëve, analiza vjetore të njësive bazë dhe konsultime me tregun e punës. Përfshirja e literaturës së viteve të fundit tregohet si prioritet, çka ndihmon në përgatitjen bashkëkohore të studentëve. Procesi është ende në fazë zhvillimi, dhe <u>mungojnë të dhëna konkrete mbi ndikimin e këtyre ndryshimeve.</u> <u>GVJ rekomandon të jepen shembuj të qartë të literaturës së përditësuar ose moduleve të rishikuara.</u> [Ev. 1.6; 1.7]
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit është e ndarë në mënyrë logjike dhe e mbështetur në komponentë të balancuar teorikë dhe praktikë, çka ndihmon në zhvillimin e kompetencave të synuara [Ev. 1.10; 6]. Ndërthurja teori-praktikë, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës dhe metodave të mësimdhënies janë pika të forta që kontribuojnë në formimin profesional të studentëve.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi ofron një bazë të gjerë në lëndët bazë dhe karakterizuese që përgatitin studentët për ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në fusha si biokimia, gjenetika molekulare, nanoteknologjia apo bioteknologjia mjekësore. WBU deklaron se ka realizuar një studim tregu [Ev. 2.8] për të identifikuar kërkesat në sektorin e bioteknologjisë, në nivel kombëtar dhe rajonal. Në bazë të këtij studimi, është përshtatur përmbajtja e programit dhe janë përfshirë lëndë me vlerë praktike për punësim në sektorë të ndryshëm si shëndetësia, kërkimi, industria farmaceutike dhe agrobioteknologjia. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze është një komponent shtesë që rrit konkurrueshmërinë e studentëve në tregun global të punës dhe i përgatit ata për komunikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar.
Konkluzione	<i>Struktura e programit është e balancuar dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, me ndarje të qartë ndërmjet formimit teorik dhe praktik.</i> <i>Përmirësimi i vazhdueshëm i syllabuseve dhe përfshirja e literaturës bashkëkohore janë të pranishme, por mungojnë evidenca konkrete mbi ndikimin në rezultatet e studentëve.</i> <u>GVJ rekomandon të jepen shembuj të qartë të literaturës së përditësuar ose moduleve të rishikuara.</u>

	<i>Programi mbështet vijimin e studimeve dhe punësimin. Përputhshmëria me programe të ngjashme ndërkombëtare është deklaruar, por kërkon referenca më të qarta dhe krahasime konkrete për ta vërtetuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Inxhinierisë kanë ndërmarrë konsultime me institucione partnere si Grupi i Spitaleve Amerikane dhe International Hygea Hospital [Ev. 2.7; 2.8]. Këto institucione kanë kontribuar me sugjerime lidhur me nevojat për specialistë në fushën e bioteknologjisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në vendimin për hapjen e programit. Gjithashtu, përmbajtja e programit është përmirësuar në vazhdimësi nëpërmjet mbledhjes së propozimeve nga studentët diplomantë, alumni (tre vite pas diplomimit), si dhe analizës së të dhënave nga tregu i punës. Ky proces përfshin input nga studime të brendshme të realizuara nga strukturat përgjegjëse të universitetit, duke treguar një përpjekje për të mbajtur programin në përputhje me kërkesat dinamike të tregut.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti përfshin përfaqësues të studentëve në organet vendimmarrëse, si Senati Akademik dhe NJSBC, duke i dhënë atyre mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin institucional [Ev. 2.6]. Vlerësimet periodike të studentëve gjatë studimeve dhe ato në prag diplomimi përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për të gjeneruar të dhëna mbi cilësinë e programit dhe për të informuar përditësimin e tij [Takimi me studentët]. Paralelisht, pyetësorët e synuar ndaj përfaqësuesve të industrisë përkatëse ofrojnë një tjetër dimension vlerësimi për të matur performancën e të diplomuarve dhe për të identifikuar nevoja për përmirësim të mëtejshëm të kurrikulës. Përgjegjësia institucionale për këto ndërveprime është e përqendruar te Dekanati i Studentëve dhe Zyra e Alumni, të cilat synojnë të

	mbajnë kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe të diplomuarit [Ev. 1; 2].			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Edhe pse programi është relativisht i ri dhe ende nuk ka kaluar nëpër procese të riorganizimit të thelluar, janë parashikuar instrumente dhe procedura për përmirësimin dhe përditësimin e tij. Përmbajtja e programit mbështetet në analiza që përfshijnë të dhëna nga studentët, të diplomuarit dhe përfaqësues të industrisë, në mënyrë që të reflektojë realitetin dhe nevojat e tregut. Në RVB përmendet objektivi i institucionit për të kontribuar në zhvillimin e sektorëve kyç si shëndetësia, ekonomia dhe shoqëria, duke u lidhur me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe rrjete profesionistësh. Kjo qasje sugjeron përpjekje për të vendosur lidhje ndërmjet arsimit universitar dhe praktikës profesionale.			
Konkluzione	<i>Programi "Bachelor" në "Bioteknologji" në WBU është konceptuar me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut të punës, studentëve dhe alumni, për të siguruar përputhshmëri me nevojat profesionale dhe zhvillimet shkencore.</i> <i>Edhe pse programi është ende i ri, janë parashikuar mekanizma për përmirësim dhe përditësim në bashkëpunim me rrjete profesionistësh dhe institucione, megjithatë mungojnë shembuj konkretë të zbatimit praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në analizën e përgjigjeve të institucionit, vizitës në institucion, si dhe evidencave të ofruara, GVJ konstaton se WBU e përmbush kriterin 1, i cili kërkon garantimin e një procesi mësimor që mbështet aftësimin profesional të studentëve përmes metodave bashkëkohore dhe praktikave të mira me në qendër studentin. Institucioni ka harmonizuar programin e studimit me Kornizën e Kualifikimeve të Rajonit të Arsimit të Lartë “Western Balkans”, ka ndërmarrë rishikime të vazhdueshme të programit në përputhje me rezultatet e të nxënës, dhe ka aplikuar një shumëllojshmëri formash të mësimdhënies dhe vlerësimit, përfshirë leksione, seminare, diskutime, punë laboratorike, detyra dhe projekte. Gjithashtu, janë në funksion mekanizma të rregullt për matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes analizave dhe pyetësorëve periodikë. [Ev. 2; 2.1; 3.1].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	WBU tregon një përkushtim të dukshëm për të siguruar një përjasje të larmishme dhe tërheqëse në mësimdhënie nga ana e personelit akademik. Në përmbajtjen e përgjigjes nënvizohet përdorimi i metodave interaktive si diskutimet në grup, prezantimet, detyrat praktike, puna në laboratorë dhe përdorimi i platformave online për lehtësimin e të nxënës. Gjithashtu, evidentohet mbështetja që i ofrohet personelit për zhvillim profesional nëpërmjet trajnimeve dhe përditësimeve metodologjike, si dhe procesi i rregullt i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies nga studentët. Këto elementë dëshmojnë për një angazhim të mirëstrukturuar institucional në përmbushjen e këtij kriteri. Në përfundim, duke u bazuar në dokumentacionin mbështetës dhe informacionin e paraqitur, vlerësohet se institucioni e përmbush këtë kriter. [Ev. 2; 2.1; 6; 2.5].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	WBU dëshmon se ndjek një politikë të qartë e gjithëpërfshirëse për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto politika përfshijnë trajnime të rregullta që synojnë përmirësimin e metodave të mësimdhënies, si dhe përdorimin e teknologjive moderne si Tabelat Smart në auditorë. Gjithashtu, trajnimet zhvillohen mbi bazën e nevojave të identifikuara përmes pyetësorëve dhe përfshijnë si ekspertë vendas, ashtu edhe të huaj, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë pedagogjike dhe në përvetësimin e praktikave bashkëkohore të të mësuarit. Veçanërisht vlerësohet përpjekja për përfshirjen e studiuesve të huaj dhe bashkëpunimi me institucione të tjera akademike për të garantuar një zhvillim të gjithanshëm të kapaciteteve të personelit. Këto elementë tregojnë një angazhim të strukturuar

	të institucionit për të mbështetur dhe zhvilluar burimet njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë së arsimit të ofruar. [Ev. 3.2; 3.3; 3.4]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	WBU bën një përpjekje e qëndrueshme për të trajnuar dhe mbështetur stafin akademik në ndërtimin dhe aplikimin e përjasjeve moderne ndaj të nxënit me studentin në qendër. Përdoren metoda të shumta ndërvepruese si zgjidhja e problemeve, punët në grup, diskutimet, përdorimi i platformave digjitale, si dhe lidhja e koncepteve teorike me kontekste praktike. Gjithashtu, vërehet një qasje reflektuese e personelit akademik ndaj vlerësimeve të studentëve dhe ndaj nevojës për përshtatje të metodave mësimore në përputhje me zhvillimet e fundit pedagogjike dhe shkencore. Për më tepër, institucioni i ka dhënë rëndësi zhvillimit profesional përmes planeve të trajnimit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për të përfshirë në procesin mësimor persona të kualifikuar që kanë përfunduar studimet në universitete prestigjioze brenda dhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë, krijohet një kulturë akademike që mbështet rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe garanton integritimin e koncepteve bashkëkohore në kurrikulat ekzistuese. [Ev. 3.5; 2; 5]
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga vlerësimi i bërë, GVB konfirmon se ekziston një proces i mirëorganizuar për mbledhjen periodike të mendimeve të studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies, përmes pyetësorëve të strukturuar që administrohen pas çdo semestri dhe në përfundim të ciklit të studimeve. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen nga njësia përkatëse dhe shërbejnë si bazë për reflektim mbi efektivitetin e metodave të përdorura dhe për të identifikuar nevojat për përmirësim. Për më tepër, është e dukshme pjesëmarrja e studentëve në këtë proces, duke ndikuar në vlerësimin e cilësisë akademike dhe përmirësimin e përvojës së të nxënit. Këto elementë dëshmojnë një kulturë institucionale të ndërtuar mbi cilësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. [Ev. 3.5; 2.2; 6.6; 2.6: 3.6; 3.7; 2.7]
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe	Institucioni demonstroi një angazhim të qartë dhe të strukturuar në këtë drejtim, duke garantuar funksionimin efektiv të njësive përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, siç është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Raportet periodike të vetëvlerësimit dhe analizat e zhvilluara brenda strukturave akademike dëshmojnë një proces të institucionalizuar reflektimi mbi ecurinë e programit të



bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	studimit. Për më tepër, institucioni inkurajon dhe mbështet nismat e stafit akademik për të përmirësuar metodologjitë e mësimdhënies dhe për të përshtatur metodat mësimore ndaj kërkesave të reja të tregut dhe të studentëve. Aktivitetet e zhvilluara përmes analizave vjetore të performancës, diskutimeve të rregullta akademike dhe përdorimit të instrumenteve të brendshme të cilësisë përforcojnë një kulturë organizative të bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm dhe në përfshirjen aktive të të gjitha niveleve të strukturës universitare. [Ev. 1: 3.8: 3.9: 3.10: 3.11: 3.12: 3.13: 2.6; 3.3]			
Konkluzione	<i>WBU demonstroi një qasje të integruar dhe të qëndrueshme ndaj cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënësve.</i> <i>Janë në funksion struktura dhe mekanizma të qartë për trajnimin e stafit, vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin e përmirësimit.</i> <i>Ekziston një kulturë institucionale që mbështet përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen me zhvillimet bashkëkohore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	Në WBU kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë të specifikuar në mënyrë të detajuar në Rregulloren Themelore të Universitetit "Western Balkans" dhe në Rregulloren për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor në Bioteknologji". Për çdo lëndë janë të përcaktuara format e provimit (me shkrim, me gojë, provim i hapur etj.), mënyra e vlerësimit dhe përbërja e notës përfundimtare. Studentët njihen me këto kritere nëpërmjet syllabuseve dhe përmes platformës Smart WBU. Sistemi i vlerësimit është i



posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	harmonizuar me standardet ligjore dhe me parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes. [Ev. 2; 2.1; 6].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët njihen në fillim të çdo lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit përmes syllabusit të miratuar, që u prezantohet në javën e parë të zhvillimit të mësimin dhe publikohet në platformën Smart WBU. Syllabusi përmban në mënyrë të detajuar komponentët e vlerësimit, përqindjen e secilit element në notën përfundimtare dhe format e testimit. Kjo transparencë i mundëson studentit të kuptojë qartë pritshmëritë dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor. Kjo praktikë ndihmon në rritjen e përgjegjshmërisë dhe orientimit të studentit gjatë gjithë semestrit. [Ev. 2.5].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet përmes një sërë formash të ndryshme, të cilat i japin mundësi çdo studenti të shfaqë aftësitë e tij individuale. Lëndët përmbajnë larmi metodash vlerësimi, si provime të ndërmjetme, kuize, detyra shtëpie, projekte, laboratorë, prezantime dhe pjesëmarrje në aktivitete, si dhe provimi përfundimtar. Të gjitha format janë të përcaktuara në syllabus dhe bëhen të njohura që në javën e parë të zhvillimit të lëndës. Kjo qasje shumëformëshe rrit cilësinë e vlerësimit, siguron gjithëpërfshirje dhe mbështet objektivat e programit. [Ev. 139].
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i metodave të mësimdhënies realizohet përmes sondazheve periodike që studentët plotësojnë në fund të çdo semestri, përpara provimeve përfundimtare. Pyetësorët janë të strukturuar për çdo lëndë dhe përfshijnë vlerësimin e pedagogut, lëndës dhe përmbajtjes. Studentët inkurajohen të japin komente të hapura dhe të shprehura lirshëm. Të dhënat e mbledhura përpunohen në një raport-analizë institucionale, i cili përcillet në nivelet drejtuese dhe përfshihet në diskutimet e Komisionit për Sigurimin e Cilësisë. Bazuar në rezultatet dhe komentet, ndërmerren masa për përmirësimin e aktiviteteve të mësimdhënies, kërkimit apo mësimnxënies, si dhe organizohen seminare për stafin akademik me qëllim zhvillimin profesional të vazhdueshëm. [Ev. 2.6; 3.2].
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në	WBU angazhohet në mënyrë aktive për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies duke ofruar një sërë aktiviteteve trajnimit, leksionesh të hapura dhe workshopesh të zhvilluara nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Trajnimet organizohen në përputhje me nevojat e stafit pedagogjik dhe synojnë të përmirësojnë përgatitjen e tyre didaktike e kërkimore. Formate

përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	fleksibël të mësimdhënies që promovojnë autonominë e studentëve dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet stafit dhe studentëve janë në qendër të këtij përkushtimi. Gjithashtu, WBU mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, si dhe publikon gjetjet kërkimore përmes mbështetjes institucionale. Këto përpjekje lidhen me një strategji të integruar për rritjen e cilësisë së arsimit, dhe përfshijnë gjithashtu inkurajimin e përdorimit të praktikave bashkëkohore si mësim bazuar në projekte, detyra laboratorike dhe punë në grupe. Në këtë kuadër, inkurajohet ndërveprimi, kreativiteti dhe aftësimi i vazhdueshëm i studentëve në një mjedis të favorshëm dhe të mbështetur. [Ev. 3.18; 3.19; 2.5].			
Konkluzione	<i>Objektivat e programit janë të qarta, në përputhje me misionin e institucionit dhe të lidhura ngushtë me nevojat e tregut të punës.</i> <i>Rezultatet e të nxënit janë të strukturuar dhe përputhen me objektivat e programit.</i> <i>Vlerësimi i njohurive dhe aftësive bëhet përmes metodash të shumëllojshme dhe transparente, të detajuara në syllabus.</i> <i>Metodat e mësimdhënies përmirësohen periodikisht përmes feedback-ut të studentëve dhe trajnimeve të stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/	Në WBU vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe shumëformëshe, duke përfshirë projekte, detyra, teste, prezantime, punime laboratorike dhe provime (në mes dhe në fund të semestrit), të cilat i japin studentit mundësi të tregojë progres të vazhduar dhe të matshëm. Këto metoda vlerësimi janë të dokumentuara në syllabus-et e lëndëve/modulëve, të cilat publikohen që në fillim të vitit akademik dhe janë të aksesueshme në platformën Smart WBU. Vlerësimi final reflekton jo vetëm përgatitjen e studentit, por edhe

moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	përmbushjen e objektivave të mësimi të përcaktuara për secilën lëndë apo modul, duke garantuar një qasje të strukturuar dhe të përputhur me standardet akademike. [Ev. 2.5].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti “Western Balkans” e përmbush në mënyrë të plotë këtë kriter, i cili kërkon zbatimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit që rrisin transparencën dhe shmangin format e abuzimit. Institucioni përdor platformën Smart WBU për të menaxhuar procesin e vlerësimit në mënyrë transparente dhe të strukturuar, përmes regjistrimit në kohë reale të rezultateve dhe ruajtjes së gjurmëve të çdo veprimi. Sistemi i përdorimit të barcodëve për provimet, të cilat krijohen dhe printohen nga vetë platforma, garanton siguri dhe integritet duke shmangur çdo ndikim subjektiv gjatë vlerësimit. Më tej, sistemi mundëson procesin automatik të shkodimit të provimeve, duke lidhur të dhënat e studentëve me kodet përkatëse në mënyrë të sigurt dhe anonime. Ky sistem kontribuon dukshëm në një proces të drejtë, të verifikueshëm dhe pa ndërhyrje, duke garantuar objektivitet maksimal në vlerësim. [Ev. 3.20].
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Sipas dokumentacionit, çdo syllabus është i strukturuar sipas një modeli standard dhe i miratuar para fillimit të semestrit, duke përfshirë qartësisht metodologjinë e vlerësimit, komponentët përkatës dhe peshën për secilën pjesë të vlerësimit. Gjithashtu, vlerësimi është i detajuar për secilin komponent si provime, punë laboratorike, detyra, prezantime apo angazhim aktiv gjatë semestrit. Zbatimi i këtij vlerësimi dokumentohet edhe në sistemin elektronik, i cili siguron ruajtjen e të dhënave dhe përputhshmërinë me rregulloret institucionale dhe kombëtare për arsimin e lartë. Procesi i vlerësimit i referohet udhëzimeve të brendshme dhe akteve rregullatore në fuqi, duke garantuar transparencë dhe objektivitet në përmbushjen e standardeve akademike. [Ev. 3.21; 3.20; 2; 2.1]
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniti për të ndihmuar studentin të	Referuar RVB-së pas testimeve, provimeve të ndërmjetme, seminareve apo dorëzimit të projekteve dhe detyrave, studentët njihen me vlerësimin e tyre dhe marrin <i>feedback</i> për të kuptuar performancën, vështirësitë dhe mënyrat për përmirësim. Ky proces synon rritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e vazhdueshëm të studentëve. Për më tepër, parashikohet ballafaqimi me rezultatet dhe dorëzimi i procesverbalit brenda një afati të qartë kohor, duke reflektuar transparencë dhe mbështetje për të nxëniti efektiv. [Takimi me studentët]



përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni zbaton politika të rrepta kundër shkeljeve akademike, përfshirë përdorimin e softuerëve për zbulimin e plagjiaturës dhe aplikimin e rregullave të qarta për të ndëshkuar çdo formë kopjimi. WBU përdor programin antiplagjiaturë Turnitin dhe IA detector. Në bashkëpunim me projektin e cilësisë "QA-SURE", është ngritur një sistem i brendshëm për raportimin dhe menaxhimin e rasteve të shkeljes së integritetit akademik. Studentët informohen qartë mbi pasojat e plagjiaturës, të cilat përfshijnë ndëshkime serioze si humbje kreditesh apo përjashtim nga programi. Gjithashtu, zbatimi i Kodit të Etikës dhe rregulloreve përkatëse tregon për një angazhim të fortë institucional për të ruajtur standardet më të larta të ndershmërisë akademike. [Ev. 3.22; 3.23; 2.1; 3.20; 2.5; 2.4]
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në përputhje me Rregulloren Themelore të institucionit (Kreu 12, Neni 98), rezultatet pasqyrohen në mënyrë të saktë në procesverbalin e vlerësimit dhe në regjistrat elektronikë të notave. Procesverbali plotësohet nga pedagogu dhe dorëzohet në sekretari brenda afatit maksimal prej dy javësh nga përfundimi i sezonit të provimeve. Rregulli përjashton çdo mundësi manipulimi, duke ndaluar shtimin e emrave apo ndryshime të paautorizuara. Çdo gabim mund të korrigjohet vetëm nëse është teknik dhe vërtetohet me shkrim nga personi përgjegjës, me miratim të departamentit, brenda tre ditëve nga konstatimi. Kjo tregon një sistem të besueshëm, të drejtë dhe të përputhur me standardet akademike. [Ev. 2]
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Rregullores Themelore të institucionit (Kreu 12, Neni 99), studentët kanë të drejtën të paraqesin ankesë me shkrim brenda një jave nga data e publikimit të rezultateve për një provim semestral, përmes Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Sekretaria ia përcjell më pas kërkesën Departamentit përkatës për rishikim dhe rivlerësim të rezultateve. Nëse studenti nuk bindet nga ballafaqimi me pedagogun, ka të drejtë të kërkojë rishikim formal të vlerësimit, duke respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara. Kjo praktikë siguron transparencë, respektim të të drejtave të studentëve dhe një proces të drejtë e të verifikueshëm. [Ev. 2' 3.25]
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i	WBU e përmbush në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar këtë kriter, i cili kërkon që çdo kërkesë, ankimim apo shqyrtim i vlerësimit të trajtohet nga komisioni përkatës i vlerësimit dhe më pas nga një komision i posaçëm. Sipas procedurës së



posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	përshtatshëm, ankimi shqyrtohet mbi bazë të dokumentacionit dhe argumenteve përkatëse nga një komision i ngritur me vendim të Këshillit të Departamentit, i cili përbëhet nga tre anëtarë dhe vepron në mënyrë të pavarur. Komisioni njofton studentin për vendimin dhe zhvillon rivlerësimin e materialit në praninë e lektorit përkatës, duke garantuar transparencë dhe paanshmëri në proces. Vendimi final i komisionit i komunikohet studentit brenda afatit 15-ditor, dhe gjithë procesi dokumentohet dhe arkivohet sipas rregullave institucionale. Kjo qasje garanton mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe një mekanizëm të qartë e të drejtë për rishqyrtimin e rezultateve. [Ev. 2]			
Konkluzione	<i>Procesi i vlerësimit është i strukturuar, i vazhdueshëm dhe transparent, duke përfshirë metoda të shumta testimi dhe platformën Smart WBU që siguron gjurmueshmëri dhe akses për studentët gjatë gjithë vitit akademik.</i> <i>Zbatohen masa rigorozë kundër plagjiaturës dhe kopjimit, përmes përdorimit të softuerëve të posaçëm, rregulloreve të brendshme dhe masave disiplinore të dokumentuara.</i> <i>Studentëve u garantohen të drejtat për informim, ballafaqim dhe ankimim të rezultateve, sipas procedurave të qarta dhe afateve të përcaktuara në rregullore, duke përfshirë rishikim nga komisione të pavarura.</i> <i>Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve bëhet në përputhje me afatet ligjore dhe bazuar në meritë, duke ndaluar çdo korrigjim të paautorizuar dhe duke garantuar një proces të drejtë për të gjithë studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë	WBU ka organizuar planin mësimor të programit “Bachelor” në Bioteknologji në mënyrë që të sigurojë përgatitjen e duhur teorike dhe profesionale të studentëve. Ky program përfshin një strukturë të qartë dhe të balancuar mes disiplinave bazë, atyre

aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje, duke ndërtuar lidhje logjike mes tyre. Kurrikula është përditësuar vazhdimisht për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e bioteknologjisë, si dhe për të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësi praktike, mendim kritik dhe kompetenca të nevojshme për tregun e punës. Për më tepër, theksohet përfshirja e lëndëve me objektiva të qarta, që ndihmojnë në formimin profesional dhe ndërtojnë qëndrime të përgjegjshme, duke i përgatitur studentët për punësim dhe vazhdim studimesh në Shqipëri dhe jashtë saj. [Ev. 1.10]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	WBU ka integruar në program një sërë komponentësh që ndihmojnë zhvillimin e aftësive të veçanta përtej njohurive akademike. Përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe platformave online, studentët mësojnë të përdorin mjete bashkëkohore për kërkime dhe prezantime. Lëndët përbajnë elementë që nxisin komunikimin efektiv dhe punën në grup. Gjithashtu, programi përfshin projekte, laboratorë dhe praktika që zhvillojnë aftësi analitike, menaxheriale dhe sociale. Studentët përgatiten për ndërveprim profesional në fusha të ndryshme të bioteknologjisë, duke kuptuar rëndësinë e etikës shkencore dhe ndikimin social të inovacionit bioteknologjik. Kështu, WBU i përgjigjet në mënyrë të plotë këtij kriteri duke garantuar zhvillim të gjithanshëm të studentëve. [Vizita në institucion; takimi me studentët; takimi me stafin akademik]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.	WBU e trajton me seriozitet përcaktimin dhe zhvillimin e kompetencave që studentët fitojnë gjatë studimeve në programin “Bachelor” në Bioteknologji. Këto kompetenca janë të përcaktuara qartë në syllabuset e çdo lënde dhe përfshijnë aftësi teknike, profesionale dhe të menduarit kritik. Personeli akademik udhëzon studentët në zbatimin praktik të këtyre aftësive përmes provimeve, projekteve, praktikave profesionale dhe detyrave përmblylëse. Në përfundim të çdo lënde, kompetencat analizohen dhe diskutohen në mënyrë të detajuar, ndërsa studentët orientojnë drejt përmirësimit të tyre përmes vlerësimeve të vazhdueshme. Për më tepër, procesi i përditësimit të syllabusëve dhe i analizave të përvitshme nga pedagogët dhe departamentet siguron një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes profesionale të studentëve.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë	WBU ka ndërtuar infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie, përfshirë laboratorë, ambiente praktike dhe bashkëpunime me institucione të jashtme. Këto mjete lejojnë



studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	zhvillimin e aftësive praktike të studentëve në përputhje me programin akademik. Studentët marrin pjesë në praktika profesionale në institucione të ndryshme, si kompani private apo publike, që kanë lidhje me fushën e studimeve. Përmes projekteve kërkimore dhe temave të diplomës, WBU inkurajon zhvillimin e ideve inovative dhe përfshirjen aktive të studentëve në zgjidhjen e problemeve konkrete. Gjithashtu, përmes projektit EPIC, WBU mbështet zhvillimin e aftësive sipërmarrëse dhe integrimin në tregun e punës. Studenti përgatitet për sfida reale përmes metodologjive praktike, duke përfituar nga rjetet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Mësimdhënia lidhet edhe me lëvizshmërinë studentore, përmes marrëveshjeve me institucione të tjera, duke ofruar mundësi të gjera për shkëmbim akademik dhe përvojë ndërkombëtare. [Ev. 3.27; 1.17; 3.28]
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	WBU përmbush plotësisht këtë kriter përmes përfshirjes aktive të personelit akademik në zhvillimin e orëve të hapura, seminareve dhe aktiviteteve të tjera trajnuese që lidhen me zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji. Gjatë vitit akademik 2023–2024, janë organizuar takime, webinare, seminare trajnimi dhe orë të hapura me ekspertë vendas dhe të huaj, ku studentët kanë marrë pjesë si pjesë aktive e këtij procesi. Gjithashtu, WBU ka krijuar një seri të rregullt aktiviteteve nën emërtimin "<i>WBU Research Seminars</i>", duke përfshirë si pedagogët, ashtu edhe studentët, veçanërisht ata të vitit të tretë Bachelor dhe ciklit të dytë Master. Këto veprimtari jo vetëm që informojnë mbi zhvillimet aktuale, por nxisin edhe integrimin e studentëve në komunitetin shkencor. [Ev. 3.30].
Konkluzione	<i>Programi "Bachelor" në Bioteknologji është hartuar me strukturë të qartë akademike dhe përfshin përditësime të vazhdueshme që garantojnë zhvillimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës.</i> <i>Studentët fitojnë aftësi të ndryshme përmes praktikave, projekteve, përdorimit të teknologjisë dhe pjesëmarrjes në veprimtari ndërdisiplinore, duke përfshirë kompetenca në komunikim, kërkim dhe bashkëpunim.</i>

	<i>Personeli akademik angazhohet në seminare dhe orë të hapura me përmbajtje bashkëkohore shkencore dhe teknologjike, brenda dhe jashtë programit, duke mbështetur përfshirjen aktive të studentëve në kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Universiteti “Western Balkans” (WBU) zbaton një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për detyrimin përfundimtar të studentëve në programin e studimit. Kjo procedurë përfshin realizimin e një pune diplome, e cila është e publikuar në uebfaqen e universitetit dhe i komunikohet studentëve nëpërmjet platformës SMART WBU. Në këtë mënyrë, studentët kanë akses të plotë dhe në kohë reale në të gjitha kërkesat e programit. Rregullorja përcakton qartë formatin dhe afatet për dorëzimin e diplomës, kriteret e vlerësimit, si dhe notën mesatare që duhet të ketë studenti për të pasur të drejtën e diplomimit. Për më tepër, përmbushja e këtij kriteri mbështetet nga një sërë evidencash dokumentare, si trajnimet për studentët rreth kërkimit shkencor, kalendarët e trajnimeve vjetore, listat e mobiliteteve studentore dhe aktivitetet akademike, si dhe organizimi i seminareve kërkimore. Këto masa garantojnë që çdo student të jetë i informuar dhe i përgatitur për realizimin e detyrimit përfundimtar, duke e bërë këtë proces transparent dhe të barabartë për të gjithë. [Ev. 6; 1.10; 1; 2]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Universiteti ka strukturë të qarta dhe staf të kualifikuar akademik që i ofrojnë studentëve udhëzim, asistencë dhe informacion të nevojshëm për përgatitjen e punimit të diplomës. Ky proces menaxhohet nga departamenti përkatës dhe evidentohet në planet e publikimit të temave dhe rregullat për miratimin e tyre nga Senati Akademik. [Ev. 2]

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për vitin akademik 2024-2025, nuk do të zhvillohet provim final. [Ev. 3.21]
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik udhëheqës në Universitetin "Western Balkans" udhëzon dhe mbështet studentët në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit të diplomës, duke filluar nga përzgjedhja e temës deri te hartimi dhe mbrojtja përpara komisionit. Udhëheqësit ndihmojnë studentët në nxjerrjen e rezultateve, analizën e të dhënave dhe përgatitjen e përmbajtjes shkencore të punimit, në përputhje me udhëzimet zyrtare të universitetit. Ata mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentin, garantojnë cilësinë e punës dhe vlerësojnë nëse punimi është i gatshëm për t'u paraqitur për mbrojtje. Ky proces mbështetet në dokumente rregullative dhe evidenca të qarta si udhëzuesi për përgatitjen e punimit të diplomës, vendimet e Senatit për temat dhe komisionet, si dhe rregulloret përkatëse të programit "Bioteknologji". Në këtë mënyrë, WBU siguron një mbështetje akademike të strukturuar dhe cilësore për çdo student në përmbushjen e detyrimit të diplomës. [Ev. 3.31; 3.32]
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	WBU ka krijuar një infrastrukturë moderne kërkimore dhe laboratorike në dispozicion të studentëve për realizimin e matjeve, analizave dhe testimeve në funksion të punimeve përfundimtare dhe temave të projektit. Studentët e ciklit të parë kanë mundësi të kryejnë këto veprimtari kërkimore në ambientet e institucionit, të tilla si laboratorët didaktikë, kërkimorë dhe biblioteka, edhe jashtë orarit mësimor. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e këtyre proceseve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të jashtme partnere, si Grupi i Spitaleve Amerikane, International Hygea Hospital, Cambridge Clinical Laboratories dhe Forensic Center Albania (FCA), në varësi të fushës së studimit. Kjo strukturë bashkëpunuese dhe teknologjia e avancuar në dispozicion u mundëson studentëve që të zhvillojnë punë kërkimore cilësore dhe të lidhura drejtpërdrejt me praktikën profesionale, duke përmbushur në mënyrë efektive kërkesat e këtij kriteri. [Ev. 1.8; 1.9]

Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	WBU e vlerëson punimin e diplomës me notë përfundimtare, që llogaritet si pjesë përbërëse e totalit të krediteve të programit dhe është e integruar në sistemin e vlerësimit ECTS. Ky vlerësim pasqyrohet në sylabusin e lëndës përkatëse “Temë diplome” dhe është kriter për llogaritjen e notës mesatare të përfundimit të studimeve. Vlerësimi final jepet nga komisioni përkatës në përfundim të mbrojtjes së temës. [Ev. 3.33]
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	WBU garanton që, në përfundim të studimeve, çdo student pajiset me diplomë dhe suplementin përkatës, të nënshkruar nga autoritetet përkatëse dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Pajisja me diplomë realizohet vetëm pasi studenti ka përmbushur me sukses të gjitha detyrimet akademike të programit, përfshirë realizimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës. Diploma lëshohet në përputhje me modelin zyrtar të miratuar nga institucioni dhe përmban të dhëna të plota mbi identitetin e studentit, profilin e studimeve, datën e përfundimit dhe titullin e fituar. Suplementi i diplomës shoqërohet me përshkrimin e detajuar të lëndëve të ndjekura, notave, krediteve dhe kompetencave të fituara gjatë ciklit të studimeve. Të gjitha këto dokumente administrohen dhe shpërndahen në bazë të rregullores së brendshme të institucionit dhe përbëjnë dëshmi zyrtare për përfundimin e programit të studimit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. [Ev. 2].
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	WBU garanton ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni disponon kopje fizike dhe elektronike të dokumentacionit për çdo student dhe i vendos ato në dispozicion sa herë që kërkohet informacion zyrtar për studentët. Dokumentacioni ruhet sipas dispozitave ligjore në Zyrën e Protokollit dhe të Korrespondencës, ndërsa përgjegjësinë për arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave personale dhe akademike të studentëve e ka Sekretaria Mësimore. Kjo njësi arkivon dhe administron dokumente si regjistrimet, transkriptet, diplomat, suplementet dhe informacionin mbi ecurinë akademike. Nëpërmjet platformës SMART WBU, dokumentacioni digjitalizohet dhe studentët kanë akses të sigurt dhe të kontrolluar. Përdorimi i platformës SMART WBU si mjet qendror për menaxhimin e gjithë procesit të detyrimit përfundimtar të studentëve, përfshirë komunikimin me udhëheqësit, dorëzimin e materialeve, vlerësimin, si dhe arkivimin dhe aksesin digjital të dokumentacionit zyrtar në përputhje me ligjin, konsiderohet sin jë praktikë e mire nga ana e GVJ. Gjithashtu, Universiteti ndjek politika të qarta për ruajtjen e konfidencialitetit të të

	dhënave dhe për mbrojtjen e tyre nga përdorimi i paautorizuar, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto procese janë të mbështetura nga struktura dhe praktika të standardizuara të administratës universitare dhe ndihmojnë në garantimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe ruajtjes afatgjatë të dokumentacionit akademik. [Ev. 1; 3.35; 3.36; 1.13]			
Konkluzione	<i>WBU ka hartuar një procedurë të dokumentuar dhe të qartë për realizimin e detyrimit përfundimtar të studentit (punimi i diplomës), të publikuar në platformën SMART WBU dhe faqen zyrtare, duke garantuar transparencë dhe akses për studentët.</i> <i>Studentët asistohen gjatë gjithë procesit nga personeli akademik dhe struktura të dedikuara, përmes udhëzimeve, konsultimeve, komisioneve vlerësuese dhe mbështetjes teknike në laboratorë modernë dhe institucione partnere.</i> <i>Në përfundim të studimeve, studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës dhe pajisen me diplomë dhe suplementin përkatës, në përputhje me rregulloret dhe standardet ligjore.</i> <i>Institucioni ruan të gjitha të dhënat dhe dokumentet përkatëse të studentëve në formë fizike dhe elektronike, duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke përdorur platformën SMART për digjitalizimin dhe menaxhimin e sigurt të dokumentacionit, të cilën GVJ e konsideron si raktikë të mirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik për një program studimi të ciklit të parë Bachelor. Referuar të dhënave të marra mbas vizitës në institucion sipas tab 6, përbërja e personelit akademik, në tre vitet e fundit akademike, paraqitet si në vijim: Përbërja e personelit akademik, në tre vitet e fundit akademike, paraqitet si në vijim: <table><tr><th rowspan="2">Grada/tituj</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>7</td><td>2</td><td>8</td><td>1</td><td>12</td><td>2</td></tr><tr><td>MSc</td><td>7</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td><td>5</td><td>1</td></tr><tr><td>Total</td><td>15</td><td>2</td><td>13</td><td>2</td><td>19</td><td>4</td></tr></table>	Grada/tituj	2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	-	1	1	1	Prof.Asoc.	1	-	1	-	1	-	Dr./PhD	7	2	8	1	12	2	MSc	7	-	4	-	5	1	Total	15	2	13	2	19	4
Grada/tituj	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr	-	-	-	1	1	1																																											
Prof.Asoc.	1	-	1	-	1	-																																											
Dr./PhD	7	2	8	1	12	2																																											
MSc	7	-	4	-	5	1																																											
Total	15	2	13	2	19	4																																											
	Në kuadër të politikës së “brain gain”, në WBU ndiqet një praktikë e punësimit dhe integritit e personelit të diplomuar jashtë vendit. Lëndët dhe modulet mbulohen nga staf me eksperiencë në fushat e caktuara. Vihet re qe shumica e stafit akademik që është titullar lënde, nuk i përkasin kategorisë “Profesor”, siç e kërkon ligji. <i>GVJ rekomandon që Departamenti të marrë masa që titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë “Profesir”, në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi.</i> <i>Numri i orëve i realizuar nga stafi i Departamentit të Bioteknologjisë, WBU, tek disa është shumë i lartë, me shumë lende për një pedagog.</i> I gjithë dokumentacioni i çdo punonjësi ruhet në arkivën e Sektorit të Burimeve Njerëzore. Dosjet e personelit përditësohen vazhdimisht me aktivitete të reja të stafit, rezultate të kërkimit apo kualifikime. (Evidenca 3.5; Evidenca 4.1)																																																
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mesimore për programin e	Referuar takimit me stafin akademik gjatë vizitës dhe dokumentacionit të përcjellë pas vizitës në institucion (Evidenca 4.3 Ngarkesa mesimore) konstatohet se Institucioni në të dhënat e paraqitura në tabelat 12 ka bërë një lapsus																																																

studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	ndërmjet stafit akademik efektiv me stafin akademik me kontratë. GVJ saktëson se për paraqitjen e këtyre të dhënave janë marrë në konsideratë të dhënat e tabelave 4.1, 4.3 dhe 4.4 të tabelave përmbledhëse, ku për shkak të mospërputhjeve / pasaktësive të të dhënave, llogaritja është realizuar duke iu referuar të dhënave në tabelat 6.1-6.3 (emrat përkatës të stafit) dhe të dhënave të paraqitura në tabelat 4, ngarkesa mësimore për këtë program studimi në tre vitet akademike është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>760</td><td>610</td><td>150</td><td>76% / 24 %</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>1380</td><td>1125</td><td>255</td><td>81% / 19 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>1995</td><td>1605</td><td>390</td><td>80% / 20 %</td></tr></table> Evidenca 4.1;	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	760	610	150	76% / 24 %	2023-2024	1380	1125	255	81% / 19 %	2024-2025	1995	1605	390	80% / 20 %
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	760	610	150	76% / 24 %																	
2023-2024	1380	1125	255	81% / 19 %																	
2024-2025	1995	1605	390	80% / 20 %																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Qëndrueshmëria e personelit akademik deritashme, nuk është e kërcënuar nga largimet e vazhdueshme për shkak të emigracionit (pyetje specifike e GVJ gjatë vizitës në institucion). WBU ndjek politika për të qënë konkures dhe tërheqës si IAL për burime njerëzore cilësore, duke investuar në rritjen profesionale gjatë viteve. Si IAL ka qëndrueshmëri në staf akademik me kohë të plotë, megjithese eshte ne fillimet e tij. Punësimi i personelit në WBU respekton kërkesat e Kodit të Punës, me kontrata individuale punësimi dhe mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe sidomos kete te fundit, qe e ben me mbeshtetjen ne masen 30-70% te pinonjesve dhe studenteve te WBU. Evidenca 4.5; Evidenca 4.7;																				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	WBU në përputhje me nje rregullore te brendshme te institucionit, (si dhe me afatet kohore ngre komisionet e vlerësimit në departament dhe e përcjell në Dekanat, e më pas ne Rektorat. Komisioni i departamentit bën vlerësimin e aplikantëve në përputhje me kriteret e shpallura, shqyrton dosjen e aplikimit sipas formularit të vlerësimit dhe harton listën e kandidaturave, sipas pikëve të grumbulluara, në rendin zbritës për çdo kandidat së bashku me pikët e intervistës. Miratimi behet nga Bordi i Administrimit. Njoftimi online behet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Në																				

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	fund personeli pajiset me kontratën përkatëse individuale të punës. Për nevojat etij, WBU punëson me kohë të pjesshme personel akademik, administrativ si dhe kontraktin ekspertë të jashtëm. Evidenca 4.12; Evidenca 4.14; Evidenca 4.13; Evidenca 4.7;
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	WBU garanton mbarëvajtjen e praktikave mësimore (laboratore) në ambiente adekuate dhe me personelin e duhur akademik dhe ndihmës akademik, ku përmendim që edhe personeli ndihmës është i kualifikuar. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. Për realizimin me sukses të objektivave të programit të studimit cikli i parë “Bachelor” në “Bioteknologji” janë angazhuar personel ndihmës akademik me karakter akademik. Personeli ndihmës akademik përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit dhe kanë fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të Universitetit. Evidenca 2.3; Evidenca 1.12;
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GJV konstatoi se WBU, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Bioteknologji”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër, si dhe dosjen personale për staf jo akademik. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu GJV evidentoi që çdo fund viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi i

akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Departamentit. Të dhënat përfshijnë listat e personelit të angazhuar për çdo semestër dhe vit akademik, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Evidenca 1.12;
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	WBU ka shumë marrëveshje, duke krijuar një rrjet bashkëpunimi midis WBU me IAL të tjera publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit. Vetë departamenti ka në dispozicion stafin e mjaftueshëm për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikën profesionale, apo dhe hulumtimet që studentet mund të bëjnë në realizimin e diplomave. Temat dhe drejtuesit e diplomave, caktohen nga Njesia Baze dhe miratohen nga dekani. Evidenca 1.8.; Evidenca 1.9.; Evidenca 1.16;
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Stafi akademik mbikëqyrës angazhohet dhe kontribuon në mënyrë aktive në plotësimin e praktikës profesionale të studentit, Universiteti "Western Balkans" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet partnere, si me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe International Hygea Hospital SH.A, Cambridge Clinical Laboratories, etj., ku kryhen praktikat profesionale, në kuadër të formimit të plotë teorik dhe praktik të studentëve. Praktikën profesionale dhe zhvillimi i tyre mbikëqyren nga personeli përgjegjës dhe në përfundim të tyre mbahet një dokumentacion i plotë vlerësues. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Institucioni mbështet zhvillimin dhe aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët, nëpërmjet programit Education Practice - Integrated Curriculum (EPIC) (https://wbu.edu.al/sq/epic) Në këto përfshihen dhe stafi ndihmës, i cili jep kontribut në këtë drejtim.

	Vizita në institucion; Evidenca 1.9; Evidenca 1.8; Evidenca 1.16;			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për një program studimi të ciklit të parë Bachelor.</i> <i>Ka qëndrueshmëri personeli, gjë që reflektohet në kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</i> <i>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi, por në më të shumtën e personelit efektiv e kalojnë limitin. Procesi i rekrutimit bëhet sipas ligjit, Statutit, etj.</i> <i>GVJ rekomandon që stafi akademik që është titullar lënde, të jetë i kategorisë “Profesor”, siç e kërkon ligji, si dhe të ketë më tepër bashkëpunime kërkimore gjë që do të rrjedhin dhe nga realizimi i diplomave, me drejtim kërkim-eksperiment, dhe jo vetëm provim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB-së, WBU zhvillon procesin mësimor në 3 godina. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi ambjente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit Bachelor në Bioteknologji, duke konsideruar kurrikulën, numrin e grupeve dhe numrin e studentëve. Për të mundësuar këtë program studimi, Uniuersiteti ka në dispozicion: • 27 auditorë mësimorë; • 27 laboratore te pajisur mjaft mire; • 1 sallë konferencash; • zyra për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademik;

	• ambjente të tjera; Vizita në Institucion; Evidenca 4.18; Evidenca 4.19. Evidenca 4.10;
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologji e teknologji bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	WBU disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij. Ambientet e fakulteteve (salla leksionesh e seminaresh, laboratorë didaktikë mësimorë) janë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor për studentët dhe personelin akademik. Sipërfaqet në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Sallat e auditoreve dhe laboratoreve janë të pajisura me tabelat inteligjente (SMART BOARD) që përdoren gjatë procesit mësimor. Evidenca 1.6; Vizita në Institucion;
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Referuar RVB-së, në nivel programi studimi në të dhjetë (nga 27) laboratorët mësimorë dhe kërkimorë, ku zhvillohen orët laboratorike, të Bioteknologjisë, janë të pajisur dhe plotësuar me mjete mësimore, aparatura dhe reagentë në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Ambientet laboratorike janë të pajisura me mjetet e nevojshme për procesin mësimor. Gjatë vizitës në institucion GJV konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera. Evidenca 4.25; Evidenca 4.24; Evidenca 4.23;. Vizita në Institucion;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	U konstatua se WBU ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera, ka veprimtari interaktive dhe akses në programet dhe databaza specifike në dispozicion të studentëve dhe stafit. WBU ka vënë në dispozicion të personelit dhe studentëve, shërbime internet, laboratorë dhe asete të tjera teknologjike. Sallat janë të pajisura me Smartboards, për të lehtësuar procesin mësimor. Gjithashtu ambientet e bibliotekës janë të pajisur me kompjuter, ku ndër të tjera personeli dhe studentët kanë në dispozicion bibliotekën dhe një database Digjitale.

	Një vlerë e shtuar dhe risi e institucionit është dhe krijimi I laboratorit të VR (Virtual Reality). Vizita në Institucion; Evidenca 4.22; Evidenca 4.29; Evidenca 4.28;.Evidenca 4.27;. Evidenca 4.26;			
Konkluzione	<i>Duke u bazuar ne evidencat në dispozicion dhe vizitën në Institucion, GVJ konkludon se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e laboratoreve dhe veprimtarive të tjera praktike.</i> <i>WBU ka një laborator të informatikës te pajisur me kompjutera, ka veprimtari interaktive, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale janë të garantuara për mbarëvajtjen e programit të studimit. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën angleze dhe shqipe si dhe leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë program studimi, si dhe nga vizita në Institucion vuri re se në bibliotekë janë librat kryesorë të lëndëve. Materialet janë si për të mbuluar pjesën e lëndëve bazë, ashtu edhe për ato të lëndëve profesionale. Literaturat ne Syllabuse, mund te jene me specifike. Literatura në bibliotekën e WBU ndodhen si gjendje fizike, po ashtu edhe digjitale, falë anëtarësimeve që institucioni ka bërë në JSTOR apo Research4Life. Biblioteka e WBU garanton tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese të mjaftueshme në sasi dhe cilësi. Edhe pse aktualisht në fazën e regjistrimit, burimet fizike janë mbi 30.000 të tilla, ku 6.300 janë regjistruar deri tani, mbi 250000

Handwritten signature

	tituj librash elektronikë. Biblioteka mundëson gjithashtu 36 burime online, të cilat aksesohen nga web faqja e bibliotekës https://library.wbu.edu.al/. Evidenca 1.13; Evidenca 4.31; Evidenca 4.30;
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit WBU pasuron titujt e bibliotekës. Librat që shërbejnë për plotësimin e fondit të Bioteknologjise, WBU, porositen e shfrytëzohen nga stafi i departamentit e studentët. GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për sigurimin e literaturës në WBU është Biblioteka e WBU (WBU Library) https://library.wbu.edu.al/-e. Kjo zyre, raporton dhe informon periodikisht stafin për përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit. Nderkohe, Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe Bibliotekës është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të titujve të ardhur në bibliotekë për përdoruesit, studentë apo personel. Eshte mundësuar aksesimi dhe përdorimi i materialeve, teksteve dhe publikimeve nëpërmjet abonimeve në biblioteka online, sikurse është edhe JSTOR apo Research4Life. Funksionimi i bibliotekës bazohet në Rregulloren e bibliotekës. Evidenca 4.29; Evidenca 4.28; Evidenca 4.30; Evidenca 4.32;
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore salla me shume vende. Të gjithë studentet mund të punojnë në salla, me titujt që posedon biblioteka. Burimet e pasura të bibliotekës mund të aksesohen nga Stafi akademik dhe administrative dhe studentët, duke ndjekur rregullat specifike të bibliotekës, të përcaktuara në Rregulloren e Bibliotekës. Biblioteka e WBU-së ofron huazimin e burimeve fizike, akses në burimet elektronike dhe online që ajo disponon. Qasja në burimet elektronike për përdoruesit mundësohet në të gjithë kompjuterët e lidhur në rrjetin e WBU-së, ose nëpërmjet 'autentifikimeve me mail'. Vizita në Institucion; Evidenca 4.32;.Evidenca 4.33; Evidenca 4.30;
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit. Biblioteka ka fond fizik të bibliotekës mbi 30.000 tituj, ku 6.300 janë regjistruar deri më tani, mbi 250000 tituj librash elektronikë, etj. Biblioteka mundëson 36 burime online, të

Alolo
[Signature]

dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	cilat aksesohen nga web faqja e bibliotekës https://library.wbu.edu.al/ . Burimet e bibliotekës janë zgjedhur duke marrë parasysh kurrikulën dhe vlerat universitare. Vizita në Institucion; Evidenca 4.32; Evidenca 4.33; Evidenca 4.30;
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë për gjithë studentët dhe stafin. Aktualisht WBU është i regjistruar në dy biblioteka online JSTOR dhe Research4Life. Studentët kanë mundësi të kërkojnë dhe aksesojnë libra, artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit, si dhe moduleve të këtij programi studimi. Evidenca 4.34; Evidenca 4.32;
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. WBU ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi aksesimi në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit "Bioteknologji", për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër të gjitha punimet, materialet didaktike, librat universitar duhet të depozitohen në bibliotekë, duke e pasuruar më shumë atë. Vizita në Institucion;
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ka orare të përcaktuara për studentët. Oraret ishin të afishuara në bibliotekë. Biblioteka e Universitetit "Western Balkans" është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Biblioteka ka në dispozicion mbi 100 vende dhe mbi 260 anëtarë https://library.wbu.edu.al/ . Për huazimin e fondit fizik, Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe të personelit akademik gjatë orarit zyrtar të punës, 08:30 deri 16:30, të shpallur në mjediset e saj dhe të publikuar edhe në faqen e internetit, ndërsa fondi digjital mund të aksesohet në çdo kohë nga web-i i WBU dhe llogaria personale e studentit / personelit akademik, duke u loguar në platformën "SMART-WBU". Evidenca 4.34;. Evidenca 4.32;.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	Departamenti ndjek cilësinë e programit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të

Atto
OK

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	fondit fizik dhe online nga personeli akademik dhe studentët dhe mat efektivitetin dhe nevojën e pasurimit të vazhdueshëm të fondit me sugjerime të stafit akademik për nevoja që ato kanë për literaturë. Biblioteka, në bashkëpunim me strukturat përkatëse përgjegjëse për programet të studimit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin e tyre me tituj të rinj, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. Përpqen për të pasuruar fondin e bibliotekës me botime të viteve të fundit dhe nga shtëpi botuese të njohura botërisht, si Springer, Taylor and Francis, Willis, etj. Evidenca 4.35;			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale sigurojnë mbarëvajtjen e programit të studimit.</i> <i>GVJ konstaton se shumë vëmendje i eshte dedikuar përditësimit të literaturës, e cila realizohet në mënyrë periodike nga titullarët e lëndëve.</i> <i>Biblioteka dhe njësitë e tjera përgjegjëse ndjekin në mënyrë sa më të efektshme pasurimin e fondit fizik dhe atij online dhe cilat janë kërkesat për tituj.</i> <i>Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	WBU disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Të gjitha të dhënat e studentëve dhe dokumentacioni i tyre, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, dhe këto administrohen nga sekretaria mësimore e IAL. Institucioni disponon digjitalizimin e dokumentacionit nëpërmjet platformës SMART WBU. Zyrat administrative si: Sekretaria Mësimore dhe Burimet Njerëzore realizojnë mbledhjen dhe përpunimi i statistikave. Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti, lidhur me studentët, sipas Rregullores mbi organizimin administrativ. Universiteti "Western Balkans" disponon një sistem menaxhimi, i cili bazohet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Ky sistem administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Gjithashtu, WBU ka databazë për ruajtjen në formatin elektronik të të dhënave të studentëve, që fillojnë me gjeneralitetet e tij, dokumentacioni i shkollës së mesme, data e regjistrimit, programi i studimit, matrikullimi, numri i telefonit, e-maili, nr. ID, gjendja civile, vendlindja, vendbanimi, foto e studentit, pagesat, etj). Vizita në Institucion; Evidenca 3.37; Evidenca 2;
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni i stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në IAL. Dokumentacioni arshivohet dhe ruhet në arkivën e IAL. Zyra e Burimeve Njerëzore administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, si dhe lëvizjet e tyre në departamente, në përputhje me nevojat e fakulteteve, brenda fushës së tyre të mësimdhënies. Evidenca 3.35;
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe	Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në WBU, GVJ-ja konstatoi se sistemi i menaxhimit është i organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të sistemit përqendrohen kryesisht në përdorimin e sistemit për konsultimin e informacioneve apo

studentët e programit të studimit.	dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, listat e notave dhe krediteve. Komunikimi (personel akademik, studentë, personel joakademik) realizohet edhe nëpërmjet adresave elektronike të emailit me domain e institucionit. Komunikimi ndërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij program studimi. Evidenca 3.35;
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Stafi akademik përveç komunikimit me grupet mësimore, përdor dhe platforma të edukimit SMART., me anën e të cilave shkëmbehen informacione dhe materiale me studentët. GVJ-ja konstaton se platforma "SMART-WBU" është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi i platformës, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materiale, si dhe realizimin e Quizz-ve, Assignments në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca 1.13; Evidenca 4.36;
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet regjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës, në fillim dhe mbarim të procesit mësimor. GVJ konstaton se në tërësi sistemi i menaxhimit të WBU bëhet në mënyrë të dokumentar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. Takim ne Institucion;
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	Pas konsultimit të website të WBU, GVJ konstatoi se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, stafin akademik, si dhe një sërë informacione dhe aktivitete të tjera publikohen

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	në faqen e internetit në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën të angleze. Evidenca 2.1;			
Konkluzione	<i>IAL disponon sistem të menaxhimit, SMART, nëpërmjet të cilëve administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre.</i> <i>Faqja web e WBU, jep gjithë informacionin e detajuar për programin e studimit, stafin akademik përgjegjës, aktivitete etj, edhe në anglisht, dhe jo vetëm në gjuhën shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	WBU harton çdo vit raportin financiar i cili realizohet nga zyra e financës së IAL. Institucioni harton një raport financiar të kostove për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Dokumenti diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Pas miratimit, raporti i dërgohet MAS-së dhe publikohet në faqen zyrtare të WBU-së. Bordi i Administrimit miraton fond të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të studentëve, apo për aktivitete kërkimore shkencore të stafit. Sipas Statutit të WBU, të ardhurat e krijuara nga universiteti përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës. Evidenca 4.38;
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të	Zyra e financës administrojnë gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këtë kriter. Plani i financimit për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve të

programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit. Evidenca 4.40;
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	WBU kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Zyra e financës administron gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këtë kriter. Njësia që ka një kërkesë, plotëson formularin standard të “Kërkesë për Furnizim / Pajisje me Materiale” dhe ia paraqet atë Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative, e cila përpara miratimit të kërkesës, verifikon përshatjen e kërkesës me limitet e përcaktuara në buxhet. Evidenca 4.40; Evidenca 4.40; Evidenca 4.8;
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Departamenti nuk zotëron buxhet të veçantë dhe nuk ka raporte financiare sepse WBU e ka të përqëndruar financën dhe në raportin vjetor financiar, WBU paraqet të dhëna mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Administratori i fakultetit është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të fakultetit. Ai realizon administrimin financiar dhe administrativ të fakultetit, mbikëqyr si dhe kontrollon veprimtarinë financiare të fakultetit, plotëson kërkesat e dekanit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare. Evidenca 1.13;
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre	Suksesi i vazhdueshëm në menaxhimin, drejtimin dhe diplomimin, tregon për një qëndrueshmëri institucionale dhe financiare por, më shumë duhet bërë për të arritur cilesinë që studentët e Bioteknologjise e kanë të garantuar. Institucioni ka planifikuar në mënyrë adekuate kërkesat për fonde nga granti i IAL apo burime të tjera, dhe deritashmë nuk ka pasur vështirësi të papritura për mungesë fondesh, pasi parashikimet janë bërë në kohë dhe kanë përfshirë nevojat e


programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	strukturave të tij. Bord Administrimit përcakton gjithashtu rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron Universiteti "Western Balkans" nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si edhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Evidenca 4.41;			
Konkluzione	<i>WBU garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i> <i>GVJ rekomandon përcaktimin e një buxheti të detajuar në rang njësie Bazë, si p.sh, për Departamentin e Bioteknologjisë, dhe jo vetëm buxhetin e FSHN, WBU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti "Western Balkan" Tirane ka hartuar Statutin dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Statutin e WBU, rregulloret e FET, rregulloren e Departamentit të Bioteknologjisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave

	të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedura e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Bioteknologji”, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS). Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Me vendim të Senatit Akademik, është miratuar ngritja e Bordeve të Tregut të Punës dhe Planifikimit të Karrierës pranë çdo fakulteti të WBU-së, me qëllim realizimin e studimeve dhe identifikimin e elementeve të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, duke synuar rritjen e cilësisë. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen web të universitetit. Evidenca 2;
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej nga statuti i WBU, rregullore e Fakultetit, rregullore e Departamentit dhe rregullore e Programit të studimit. Në programin e studimit pranohen kandidatët të cilët kanë mbaruar me sukses Maturën Shtetërore, sipas Udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR. WBU ka hartuar një procedurë të veçantë për studentët e huaj, ku janë përcaktuar kriteret specifike që duhet të plotësojnë për t’u pranuar si student në një nga programet e studimit të ofruara nga WBU. Aplikimi bëhet online në faqen web të WBU https://wbu.edu.al/en/international-admissions, ku studentët gjejnë informacion të detajuar për programet, tarifat e studimit, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. Evidenca 5.3; Evidenca 5.2; Evidenca 2;
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës	Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në WBU, bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitit akademik. Departamenti merr pjesë në hartimin përpara çdo viti akademik të kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Ato dërgohen në QSHA dhe MAS, si dhe publikohen në faqen e WBU. Evidenca 1; Evidenca 2;



shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në programet e ciklit të parë, kriter i përgjithshëm i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM. Kandidati duhet të ketë përfunduar arsimin e mesëm në brenda ose jashtë vendit. Diploma e arsimit të mesëm, e marrë në një shtet të huaj duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MAS. Në faqen e web-it të WBU gjenden kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Në programin e studimit parashikohen edhe politikat e pranimit të studentëve. Gjatë Javës së Orientimit Akademik (Academic Orientation Week), studentët informohen mbi mënyrat dhe procedurat e vlerësimit të dijeve, përparimit dhe të diplomimit që në javën e parë të ciklit të studimeve, si dhe në javën e parë për çdo lëndë gjatë prezantimit të syllabusit. Studentët, për çështje specifike, mund të kërkojnë informacion nga këshilltari akademik, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit. VKM 436, dt. 30.06.2020; Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 2.1;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me WBU, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet fushatës sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve për studentë në këtë program studimi. Zakonisht kjo fushatë konsiston në takimet e programuara me maturantë në gjimnaze publike dhe private në vend. Kandidatët për student, për probleme specifike, mund të kërkojnë informacion edhe nga Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve. WBU merr pjesë në panairë të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit, ku informon kandidatët për student mbi ofertën akademike dhe kriteret e nevojshme për t'u regjistruar në këto IAL. Evidenca 2.1; Evidenca 1.13; Evidenca 4.37;
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	Para fillimit të vitit akademik WBU parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjiptian). Kriteret për

kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara janë në përputhje me Udhëzimin nr. 17, datë 30.07.2019. Në ambientet e hyrjes së godinës kryesore të institucionit janë ndërtuar rampa të përshtatshme për përdorimin e mjeteve ndihmëse nga kjo kategori sociale. Evidenca 5.5;			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	WBU në rregulloren e programit ka parashikuar kriteret për pranimin e studentëve të huaj. Pranimi i studentëve të huaj bëhet me konkurim të organizuar nga WBU. Studenti i huaj duhet të zotërojë njohjen e gjuhës shqipe, e vërtetuar përmes testeve kombëtare. Udhëzues 17, dt 30.7.2019; Evidenca 5.5;.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	WBU ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta. Referuar rregullores së bursave përcaktohen llojet e bursave si dhe mënyra e vlerësimit dhe procesi i akordimit të tyre. WBU ka ofruar bursa ekselence, bursa institucionale, si edhe bursa studimi, për maurantët që vijnë nga zona të veçanta në vend. Evidenca 4.16; Evidenca 5.6; Evidenca 5.7; Evidenca 5.8;			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se WBU siguron harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>Pranimi i kandidatëve të rinj, bëhet në përputhje me kriteret e pranimin dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitit akademik.</i> <i>FETSH organizon takime me maurantët e shkollave të mesme, për ti informuar ata lidhur me programet e studimit.</i> <i>WBU parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara, apo dhe të atyre nga trojet</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullatore institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në web-in e WBU. Vlerësimi realizohet përmes një klasifikimi sistematik, sipas një plani dhe një metode të caktuar, i rregullt dhe transparent, i vazhdueshëm dhe i mirëorganizuar, i cili përkufizohet si kontroll sistematik i vlerësimit të dijeve dhe i shlyerjes së detyrimeve të mbartura nga studenti, që synohen nga vetë programi. Evidenca 6; Evidenca 2.1;
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatore, procedura të miratuara e të bëra publike (Udhëzues nr. 17 , dt. 30.07.2019). Normalisht Komisioni Ad-hoc i ngritur nga departamenti, ben vlerësimin e dokumenteve të paraqitura nga studentët e interesuar për të transferuar studimet, por deri tani nuk ka patur raste transferimi. Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 2.1;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi, rregullorë dhe mbarëvajtje provimi (Takim në institucion). Sqarohen pikët, mënyra e vlerësimit, nota kaluese, rregullat e hyrjes në provim dhe mbarëvajtjes së provimeve. Evidenca 2.1;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni jep informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj Në fushën e studimit Bioteknologji do të aplikohet diploma, dhe jo provimi. Evidenca 4.37;. Evidenca 2.1.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë	Çdo fillim viti akademik WBU harton kalendarin përkatës dhe organizon vizita nëpër shkollat e mesme me nxënësit maturan të për t'i njohur ata me programet e studimit që ofron IAL. Kalendar i përcillet për dijeni Zyrës Vendore të Arsimit



publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Parauniversitar. Zyra e Zhvillimit të Karrierës në WBU organizon takime me maturantët për programet e studimit të WBU-it, shpërndan postera, përgjigjet për pyetjet që kanë të interesuarit. Spotet publicitare janë gjithashtu një praktikë që WBU ndjek. Evidenca 4.36; Evidenca 5.10;			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se WBU vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program, Ditët e hapura të informimit organizohen gjatë gjithë vitit akademik.</i> <i>Informacionet shpërndahen në faqen zyrtare të WBU dhe në rrjetet sociale të universitetit, ku studentët e ardhshëm gjejnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi ofertën akademike, kurrikulat, tarifat e studimit për çdo program, mundësinë e përfitimit të bursave, dhe çështje të tjera me interes.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit, <i>përmes përgjegjësit të departmentit dhe strukturave të tjera drejtuese</i> . Detaje të hollësishme mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen, vlerësimin në kredite, etj., janë të përcaktuara në kurrikulën e çdo programi studimi, janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme nga website i Universitetit “Western Balkans” në gjuhën shqipe https://wbu.edu.al/sq dhe në gjuhën angleze https://wbu.edu.al/en . GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në Bioteknologji informohen në fillim të vitit të parë akademik nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi,

	si dhe sekretaria mësimore e Fakultetit për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi, si dhe i sqaron për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kenë studentët. Evidenca 4.36;
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndës: zhvillimin e mësimin në auditor në formën e leksioneve apo seminareve, tipologjinë e ushtrimeve; format e kontrollit të vazhdueshëm, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje për provime, përgatitje e diplomës, etj. Referuar Platformës Smart WBU, GVJ konstatoi se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Ky informim vazhdon gjatë gjithë vitit akademik. Evidenca 1.13;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në nivel fakulteti apo universiteti, studentët informohen për aspekte, për të cilin ata janë të interesuar si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Studentët bëhen pjesë e panaiereve dhe workshop-eve të organizuara nga universiteti, duke marrë informacionet e nevojshme për mundësitë që ofron tregu aktual i punës. Evidenca 5.13; Evidenca 5.13;
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve. Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Mundësitë e punësimit për çdo program studimi iu bëhen me dije studentëve që në momentin e parë që ata njihen me përmbajtjen e programit. Në faqen web të Universitetit, në rubrikën studentët, gjenden informacionet e nevojshme për studentët, që aktualisht ndjekin studimet dhe për studentët e ardhshëm. Zyra e Planifikimit të Karrierës, e cila është në varësi të Dekanatit të Studentëve, krijon lidhjet e duhura midis universitetit, institucioneve publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare me synimin kryesor orientimin



	e studentëve drejt tregut të punës, duke lehtësuar integrimin e tyre dhe duke bërë të mundur që këto institucione të përthithin staf cilësor dhe të angazhuar. WBU mundëson krijimin e praktikave dhe njohurive që përfitohen përmes programit EPIC. Ndërkohë, edhe pse numri i të sapodiplomuarve në Universitetin “Western Balkans” është ende i ulët, WBU ka themeluar gjithashtu Zyrën e të Diplomuarve (Alumni Office), e cila shërben si një urë lidhëse midis universitetit dhe të diplomuarve prej tij. Evidenca 5.13; Evidenca 1.13;			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në nivel programi studimi është koordinatori dhe përgjegjësi i departamentit për t’i asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elementë të detajuar të programit të studimit. Studentëve, të cilët ndjekin studimet pranë WBU, ju vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Personeli i WBU-së dhe studentët janë të pajisur që të gjithë me adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit. Studentët informohen mbi mundësitë e mobilitetit.</i> <i>Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative. Programet e lëndëve, syllabuset, apo vlerësimin, etj. gjenden edhe rrugë të tjera informimi, si sistemi smart</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e	Në WBU arkiva përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve, që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive

të diplomuarve, në programin e studimit.	mësimore të fakultetit. Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e për programin e Ciklit të Parë Bioteknologji. Evidenca 1.13; Evidenca 5.15;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretarët mbajnë regjistrin e regjistrimeve për programin e studimit Bioteknologji, regjistrin e notave, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhëra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj. Në sekretarinë e Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, ruhen listat e plota të studentëve që nuk kanë vazhduar me sukses programin e studimit. Këto të dhëna disponohen në variantin elektronik dhe në atë të shkruar. Në programin Bioteknologji, për vitet akademike 2022-2023 e në vazhdim, nuk ka patur të tërhequr nga programi i studimit Bioteknologji. Sipas të dhënave të marrë gjatë vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon: Viti akademik 2022 – 2023 10 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 8 studentë; Viti akademik 2024 – 2025 11 studentë; Evidenca 3.37;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve të programit Bioteknologji, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit,, WBU, menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të gjitha të dhënat e studentëve administrohen nga sekretaria mësimore e WBU. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave realizohet nga Sekretaria Mësimore, kjo e fundit është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti, lidhur me studentët. Nëpërmjet platformës SMART WBU365 https://smart.wbu.edu.al/ , institucionidisponon dixhitalizimin e dokumentacionit sipas njësive prodhuese. Të gjitha këto informacione janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar në momentet kur është e nevojshme. Autorizimi i të dhënave jepet nga titullari i institucionit, në përputhje me rregulloren përkatëse. Evidenca 3.37; Evidenca 3.36;
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte,	Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e



kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme. WBU dhe Departamenti realizon kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga WBU, (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj), dhe vlerëson saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre. Çdo kontroll apo auditim periodik I brendshëm shoqërohet me një raport, i cili ju vihet në dispozicion strukturave drejtuese të institucionit për marrjen e masave për përmirësimin e situatës nëse konstatohen probleme. Takim në institucion; Evidenca 4.8;			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësim. Takim në institucion; Evidenca 4.8;			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se WBU disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</i> <i>Sekretaria mësimore ka të dhëna për çdo student në variantin elektronik dhe në atë të shkruar.</i> <i>WBU dhe Departamenti realizojnë kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga WBU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të WBU është garantuar në Rregulloren Themelore të WBT dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, në Komisionet e përhershme, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, apo mund të marrin pjesë në mbledhjet e departamentit 1 herë në muaj të cilat janë të hapura për studentët. Studentet janë të organizuar dhe në Klubet e studenteve, që varen nga Dekanati i studenteve, duke organizuar aktivitete të ndryshme akademike, sportive, artistike, etj. Takim në institucion; Evidenca2; Evidenca 2.9; Evidenca 5.17; Evidenca 5.18;
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli studentor është organ kolegjial përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Këshilli zgjidhet në mënyrë demokratike dhe angazhohet të përfaqësojë interesat e të gjithë studentëve pa dallime ideje, feje, gjinie, ngjyre, orientimi, etj. Gjatë veprimtarisë së vet, Këshilli përcjell zërin e studentëve dhe punon për fuqizimin e tyre duke nxitur pjesëmarrjen e studentëve në vendime që kanë të bëjnë me strukturat mësimore-shkencore dhe atyre të shërbimeve. Përfaqësuesit e studentëve organet kolegjiale brenda institucionit shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, etj. Evidenca 5.21; Evidenca 1.13;
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe	Ndër strukturat pjesë e WBU në përmirësimin e programit të studimit janë edhe Studentët aktualë në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit. Ata janë të ftuar në gjithë diskutimet në nivel programi studimi. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit garantohej përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programet e studimit, anëtarët e

reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ dhe studentët në programet respektive të studimit. Ata mund të përcjellin mendimet e tyre jo vetëm në Dekanat, por edhe në hallkën më të lartë të miratimit të planeve mësimore, Senatin Akademik, ku dy prej anëtarëve janë përfaqësues nga studentët. Evidenca 2.1;			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. WBU ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit. Çdo provim parashikon edhe ditën e dhënies së rezultatit individualisht ku studenti ka të drejtën edhe të ankimimit. Brenda javës së parë të çdo semestri, pedagogët duhet të publikojnë sistemin e vlerësimit në lëndët përkatëse. Rezultatet e arritura në çdo lëndë u dorëzohen organeve administrative të departamentit, brenda afatit të përcaktuar në kalendarin akademik dhe rezultatet publikohen në faqen personale të studentëve. Evidenca 2.1;			
Konkluzione	<i>Studentët përfshihen në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre, përmes përfaqësimit të tyre në Senatin Akademik, Komisionet e përhershme, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje	WBU ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t e cila është në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Veprimtaria e zyrës së këshillimit të karrierës, sipas edhe Statutit (Evidenca I: Statuti WBU), orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre që në

me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Këshillimit të Karrierës ka ngritur një sistem të posaçëm informimi, ajo përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundshme në konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, që është edhe njësia bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësive të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. Evidenca 1.13; Evidenca 3.35;
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	WBU në bashkëpunim me Zyrën e KSGC organizon aktivitetet e përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit për njohjen e studentëve me universitetin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit. Zyra për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Universiteti “Western Balkans” ju qëndron pranë studentëve jo vetëm memësimdhënien cilësore, por edhe me një këshillim cilësor karriere. Dekani i studentëve është struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin si dhe me tregun e punës. Takimi në institucion; Evidenca 1.13;
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna	Institucioni lehtëson punësimin e studentëve të tij edhe brenda IAL, por edhe me punëdhënës të ndryshëm. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës. Përveç

mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyres se Karrieres, WBU ka dhe Zyren e te Diplomuarve (Alumni Office), e cila do te jete ura lidhese midis studenteve dhe te diplomuarve. Nëpërmjet regjistrimit të të dhënave të studentit: si CV- ja, programi i studimit, rezultatet e karrierës universitare, eksperiencat e ndryshme, certifikimi i gjuhëve të huaja, fushat e interesit profesional, shërbejnë për të krijuar lidhjen me punëdhënësin, i cili ka të dhënat e mjaftueshme për t'u interesuar. Evidenca 1.13. Evidenca 5.13; Evidenca 5.22;			
Konkluzione	<i>WBU ka Zyren e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t e cila është në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.</i> <i>Zyra e Këshillimit të Karrierës ka ngritur një sistem të posaçëm informimi, ajo përditëson studentët me informacion.</i> <i>Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	WBU ka hartuar udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, si dhe përdorimin e sistemit Teams, apo dhe të tjera, në përputhje me Sigurimin e Cilësisë, brenda kuadrit ligjor të lejuar. Evidenca 2; Njëkohësisht janë përdorur Smartborde për ta bërë mësimin më atraktiv. Për përdorimin e tij, janë realizuar dhe trajnime të

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	ndryshme te stafit. Evidenca 3.16; Evidenca 6.1. Evidenca 3.17;
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	WBU ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ose KGSC, e cila është strukturë që krijohet me vendim senati dhe me mision monitorimin e sigurimit të cilësisë në WBU, dhe në njësitë kryesore të saj, për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. i cili bashkërendon punën e tij me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Evidenca 1; Evidenca 3.10; Evidenca 3.11; Evidenca 3.12; dhe çdo vit miraton një plan pune Evidenca 3.13; NJSBC, pasi bën vetëvlerësimin, në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor të cilin ia paraqet rektorit, së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezultatat e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Departamenti inkurajon kualifikimin e personelit akademik në fushën e mesimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mesimdhënies. Evidenca 2.6;. Evidenca 3.14;. Evidenca 3.15;
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mesimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mesimdhënies, të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime. Çdo vit nga NJSBC përfshihen nëpërmjet pyetësorit të gjithë studentët të cilët shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirë dhe vullnetare. Evidenca 3.9; Evidenca 2;
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm në faqen web të WBU. NJSBC-ja e zhvillon veprimtarinë sipas rregullores. Evidenca 3.13. Në mënyrë periodike NJSBC-ja informon rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësite të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Evidenca 3.9; Evidenca 2;
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mesimdhënies. Për anëtarët e personelit akademik WBU ka në dispozicion "Guidën e stafit", një dokument ky orientues për veprimtarinë e tyre brenda institucionit.

akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Evidenca 6.4. Evidenca 3.8;. Evidenca 4.12;			
Konkluzione	<i>WBU ka hartuar udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat janë bashkëkohore.</i> <i>Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ose KGSC, zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerëson në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse.</i> <i>NJSBC-ja informon rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të ligjit ligjin për arsimin e lartë IAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), WBU implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. Evidenca 3.11; Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. Ev 1. NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, një përfaqësues nga secili fakultet, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e	Në WBU funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kodin e cilësisë. Evidenca 3.13;. Evidenca 2.6;.Evidenca 6.7;. Evidenca 2.7; NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me

Alto
[Signature]

vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës, plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimi, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. Ndërsa bashkëpunëtorët e jashtëm janë të përfshirë në vlerësimin e performancës, studentët nuk janë të përfshirë në këtë proces. Evidenca 6.8;. Evidenca 3.6;. Evidenca 6.3;
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL. WBU, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes, dhe cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si, sondazhe e intervista të studentëve. Evidenca 2.6;. Evidenca 3.14;
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për	Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, WBU ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja. Treguesit e performancës përfshijnë tregues të tillë si: niveli i regjistrimeve, niveli kalueshmërisë, niveli i diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. NJSBC përpiqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standardizuar si procese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke

arritjet më të mira në programin e studimit.	realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron përmes KGSC, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC. Evidenca 3.14; Evidenca 6.1;			
Konkluzione	<i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional.</i> <i>NJSBC kryen monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë të standartizuara si procese që kryhen në mënyrë periodike, si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i> <i>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, WBU ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij.	Koordinatori i programit të studimit është personi përgjegjës i cili ndjek dhe monitoron ecurinë e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në Departamente dhe Dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit. Në këtë proces, NjBSC, njësia kryesore, njësia bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative të institucionit realizojnë evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe hartojnë planin e masave për përmirësim.

Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Programi i studimit përmirësohet duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët, vlerësimit i kolegut nga kolegu brenda departamentit, etj. Pas anketimit me studentët, bëhet rivlerësimi në nivel departamenti dhe më pas nga Senati i WBU-së. Evidenca 2.7; Evidenca 3.8; Evidenca 3.9;
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Ndërkohë, në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre. Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim. Pjesë e paketës së instrumenteve të cilësisë, përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive, me qëllim përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Evidentimi i arritjeve, të metave dhe dobësive shërbejnë për motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira nëpërmjet ngritjes në detyrë të personelit akademik, mbështetjes për organizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore, etj. Evidenca 3.6;. Evidenca 3.8; Evidenca 6.5;
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të	Departamentet e FSHN në WBU analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë: - Numri i studentëve frekuentues; - Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikave; - Plotësimi i standardeve të grupeve mësimore; - Plotësimi i standardeve të stafit akademik;

studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	- Plotësimi i standardeve të didaktikës dhe laboratorëve; - Kalueshmëria dhe cilësia semestrale; - Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale; - Numri i të diplomuarve; - Konkluzionet e pyetësorit të studentëve Evidenca 3.6; Referuar ligjit për arsimin e lartë, vlerësimi i studentëve për personelin e angazhuar dhe lëndët e programit të studimit bëhet 2 herë në vit, një herë në çdo semestër. Nga Semestri i parë i vitit akademik 2023-2024, vlerësimi i performancës në mësimdhënie i personelit akademik nga studentët bëhet në mënyrë anonime nëpërmjet platformës SMART WBU. Evidenca 2.6;
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	WBU në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të tërthorta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Departamenti, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor mënyra të tjera vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmës-akademik, që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. WBU merr pjesë gjithashtu në zhvillimin e sondazheve në nivel kombëtar, që zhvillohen nga ASCAL. Programi i studimit cikli i parë “Bachelor” në “Bioteknologji” është në vitin e tretë të tij, kështu që vlerësimi i programit në tërësi do të bëhet nga studentët në prag të diplomimit dhe ai i të diplomuarve dhe partnerëve nga industria e punës do të praktikohet në tre vitet në vijim. Në përfundim të ciklit trevjeçar, studentët e programit cikli i parë “Bachelor” në “Bioteknologji”, që diplomohen është parashikuar të bëjnë vlerësimin e programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve specifikë. Për këtë qëllim IAL ngre grup pune, i cili asiston studentët në orientimin e procesit të sondazheve, si dhe u krijon mundësi që në anonimanitet të plotë të plotësojnë pyetësorët. Takim ne institucion; Evidenca 2.7;
Konkluzione	<i>WBU monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, duke garantuar arritja e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.</i> <i>procesin e përditësimit të programeve.</i>

	WBU përdor mekanizma e proçese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimit të programeve të studimit përfshihen në raportet vjetore të WBU. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit, hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet KSGC, përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Aktet e brendshme të WBU-së parashikojnë dhe garantojnë politika, dhe procedura të brendshme të cilësisë, duke krijuar strukturat përkatëse dhe të brendshme, si Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit. Evidenca 3.11; Evidenca 3.13; Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të WBU, përfshihen politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me konventën europiane, planin e ndërkombëtarizimit të WBU, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në mënyrë që programi i studimit të njihet sa më lehtë në vendet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. Në funksion të këtij qëllimi, prioritar mbetet zhvillimi i programeve mësimore, rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj

Handwritten signature: ATOW

	nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve nga India, vendet arabe, etj. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor, do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Për përmirësimin e vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit. Vizita në institucion; Evidenca 6.7;
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Detyrat konkrete të NJSBC parashikohen në rregulloren e NJSBC, ku vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik bazohet në disa kriterë. Kjo njësi, në përmbyllje të detyrave të saj, kryen vlerësime periodike në lidhje me performancën akademike, vlerësimin e studentëve, vlerësimin e personelit akademik, ndihmës akademik apo administrativ. Gjithashtu, në mënyrë periodike vlerëson nevojat e personelit dhe studentëve. Evidenca 3.11; Evidenca 3.13; Evidenca 2.6;
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo miratohet me vendim të SA dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët pesë janë përfaqësues të personelit akademik, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, siguri i cilësisë në WBU inicion në nivel Njësie Bazë me ngritjen e grupeve të cilët merren me çështje si, rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programit të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor e kërkimor shkencor. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Financës, dhe Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, si njësi kryesore, përgjegjëse për programet e studimit. Në paketën e hartuar nga NJSBC, personeli akademik dhe ndihmës akademik vetëvlerësohet, vlerësohet nga studentët, nga kolegët dhe nga përgjegjësi i departamentit. Përgjegjësi i departamentit vlerësohet nga personeli akademik në varësi dhe nga Dekani. Dekani vlerësohet nga Senati Akademik. Kjo garanton një përfshirje të gjerë të gjithë aktorëve dhe faktorëve të

Atolo

[Signature]

	vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në institucion. NJSBC monitoron cilësinë e shërbimeve dhe infrastrukturës, si një ndër komponentët e vlerësimit të cilësisë. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorit për vlerësimin e institucionit nga personeli akademik, administrativ dhe studentët. Pas ketyre, përgatitet një raport i vjetor, me rekomandimet përkatëse. Evidenca 2.6; Evidenca 3.8; Evidenca 6.7; Evidenca 6.9;
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlerësimi i studentëve dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë, në bazë të rregullores. Evidenca 3.11; Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC) Në përzgjedhjen e anëtarëve në proceset ciklike të vlerësimit janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperiencia të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese. Departamentet raportojnë në mënyrë periodike mbi mbarëvajtjen e proceseve të cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, performancës së studentëve, etj, në njësinë kryesore. Njësia kryesore raporton një herë në vit mbi veprimtarinë e njësisë, bazuar në raportimet periodike dhe vjetore të departamenteve. Njësia shqyrton propozimet e njësisë kryesore për hapjen e programeve të reja të studimit dhe ia transmeton organeve kompetente. Pyetësorët plotësohen anonimë, ku të dhënat përpunohen dhe shpërndarja e informacioneve apo të dhënave mbi rezultatet, realizohet në mënyrë individuale, në zarf të mbyllur. Evidenca 3.9;
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	NJSBC në përbërje të saj ka një ekspert të jashtëm, i cili jep kontribut në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e raporteve të kësaj strukture. Evidenca 4.15. Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese. Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron, duke monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit. Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ekspertë të fushës, të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e



	tregut të punës. Raportet e dala, publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen web të institucionit, dhe pas përpunimit të të dhënave, jepen dhe rekomandimet përkatëse, të cilat ndiqen nga strukturat akademike, ndihmës akademike dhe administrative. Evidenca 1.2; Evidenca 3.9;			
Konkluzione	<i>IAL nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i> <i>Sigurimi i cilësisë në WBU nis në nivel Njësie Bazë, me ngritjen e grupeve, të cilët merren me çështje si rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, etj.</i> <i>Vlerësimi i studentëve dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë, në bazë të manualit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike në faqen zyrtare të WBU, fton studentët dhe stafin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet, përmes Planit të punës së KGSC. Veprimtaria e WBU-së orientohet nga një Plan Strategjik Zhvillimi 2023-2030, e cila përputhet me misionin e institucionit, me fokus kryesor ngritjen e një institucioni të gjeneratës së katërt, lider në Shqipëri, rajon dhe më gjerë në fushat e tij të fokusimit. Raportet publikohen dhe janë të aksesueshme në faqen web të institucionit. Pas përpunimit të të dhënave, nga strukturat drejtuese akademike dhe administrative të Universitetit “Western Balkans”, jepen dhe rekomandimet përkatëse. Evidenca 1.2; Evidenca 3.9;
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon	IAL në përfundim të çdo viti akademik publikon raportin vjetor të cilësisë, i cili hartohet nga struktura e NJSBC brenda

rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	institucionit Evidenca 6.11; Bëhet kujdes me të dhënat sensitive, duke ruajtur etikën dhe lirinë akademike, brenda kuadrit ligjor të lejuar. Skeda e vlerësimit individual të secilit personel i vihet në dijeni, secilit personel akademik në zarf të mbyllur, pas përfundimit të sezonit të provimeve dhe daljes së rezultateve përfundimtare të lëndës, me qëllim shmangien e çdo lloj keqkuptimi, keqinterpretimi apo abuzimi Evidenca 3.35;
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse. Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna, si dhe është menduar të ketë trajnime në fushën e mësimdhënies. WBU organizon trajnime për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Personeli akademik dhe ndihmës akademik i nënshtrohet kualifikimit dhe trajnimeve të vazhduara në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit akademik, por edhe për njohjen dhe mënyrën e përdorimit të teknikave inovative, si SMART bordeve508. Takim në institucion; Evidenca 3.16; Evidenca 3.17;
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik në WUB. i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe studentët. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstatoi se Departamenti i Bioteknologjisë, ka zhvilluar një sërë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhjen e situatave të ndryshme në praktikë, aktivitetet kërkimore-shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Vlen të theksohet dhe mbështetja e institucionit për stafin akademik, për rritjen e tyre profesionale, si pjesëmarrjen në aktivitete shkencore apo mbështetje financiare për botime Takimi me stafin akademik, RVB;

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Evidenca 3.3; Evidenca 3.2;			
Konkluzione	<i>Kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i> <i>Njësia bazë realizon analizën e punës vjetore dhe më pas njësia kryesore publikon raportin e Vetëvlerësimit për njësitë bazë dhe programet e studimit duke përcaktuar objektivat për të ardhmen.</i> <i>Drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore në sajë të problematikave të ndeshura dhe ndryshimet në tregun e punës angazhohen në funksion të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Bioteknologji”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Zhvillimi i programit të studimit në gjuhën angleze rrit ndërkombëtarizimin dhe përgatit studentët për tregun global të punës;
2. Infrastruktura laboratorike e institucionit, e përbërë nga laboratorë të specializuar dhe pajisje moderne për biologji molekulare, mikrobiologji, bioinformatikë dhe analiza të të dhënave biologjike, ofron kushte të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkime shkencore;
3. Bashkëpunimet ndërkombëtare të WBU me spitale dhe qendra kërkimore si Cambridge Clinical Laboratories, American Hospital dhe Hygea, krijojnë mundësi të prekshme për praktika dhe zhvillim profesional të studentëve në mjedise reale pune;
4. Pjesëmarrja e studentëve në kërkime të aplikuara dhe praktika profesionale në kuadër të bashkëpunimeve me institucionet kërkimore dhe spitalet ndërkombëtare, përbën një praktikë të mirë që forcon lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës në fushën e bioteknologjisë;
5. •Përdorimi i platformës SMART WBU si një mjet digjital gjithëpërfshirës për menaxhimin e procesit të detyrimit përfundimtar të studentëve – që përfshin komunikimin me udhëheqësit, dorëzimin e materialeve, vlerësimin dhe arkivimin në përputhje me kuadrin ligjor;

b. Pika të dobta:

1. Shumica e stafit akademik titullarë të lëndëve, nuk i përkasin kategorisë “Profesor”, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe evidentohet mbingarkesë mësimore për disa pedagogë, të cilët janë përgjegjës për një numër të lartë lëndësh, çka mund të ndikojë në cilësinë e mësimdhënies dhe angazhimin në veprimtari të tjera akademike; (*Standardi IV.1, Kriteri 1*)

Rekomandime:

1. Rekomandohet që titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë “Profesor”, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë, duke rritur kështu cilësinë akademike dhe shkencore të programit;
2. Rekomandohet të rekrutohet staf akademik efektiv dhe me kontratë, për të ulur ngarkesën mësimore pasi është mbi normën e lejuar, duke rritur cilësinë e mësimdhënies në disiplina të caktuara;



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Biotechnology" provided by the Higher Education Institution "Western Balkan University"

a. Strengths and affirmations:

1. The development of the study program in the English language increases internationalization and prepares students for the global job market;
2. Laboratories and modern equipment for molecular biology, microbiology, bioinformatics, and biological data analysis, provides suitable conditions for teaching and scientific research;
3. WBU's international collaborations with hospitals and research centers such as Cambridge Clinical Laboratories, American Hospital, and Hygea create tangible opportunities for student internships and professional development in real work environments;
4. Student participation in applied research and professional internships as part of collaborations with research institutions and international hospitals constitutes a good practice that strengthens the connection between theory and practice in the field of biotechnology;
5. The use of the SMART WBU platform as a comprehensive digital tool for managing the students' final assignment process – including communication with supervisors, submission of materials, evaluation, and archiving in accordance with the legal framework;

b. Weaknesses:

1. The majority of academic staff who are subject teachers do not belong to the "Professor" category, according to the requirements of the legislation in force, and there is evidence of teaching overload for some lecturers, who are responsible for a high number of subjects, which may affect the quality of teaching and engagement in other academic activities;
(Standard IV.1, Criterion 1)

Recommendation

1. It is recommended that course heads be of the "Professor" category, in accordance with the requirements of the law on higher education, thus increasing the academic and scientific quality of the program;
2. It is recommended to recruit effective and contracted academic staff, to reduce the teaching load as it is above the allowed norm, while increasing the quality of teaching in certain disciplines;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

